

QEVERIA E REPUBLIKËS SË KROACISË

1102

Sipas nenit 31 paragrafi 2 të ligjit për Qeverinë e Republikës së Kroacisë ("Fletorja Zyrtare" numër 150/2011) dhe nenit 4 dhe 73 të ligjit për kontrollin e tregtimit të mallrave ushtarake dhe pajisjeve luftarake joushtarake ("Fletorja Zyrtare" numër 80/2013), Qeveria e Republikës së Kroacisë, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2014 miratoi

VENDIMIN

PËR NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E VENDIMIT PËR MIRATIMIN E LISTËS SË MALLRAVE USHTARAKE, PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN DHE PAJISJEVE JOUSHTARAKE VDEKJEPRURËSE

I.

Në vendimin për miratimin e listës së mallrave ushtarake, produkteve për mbrojtjen dhe pajisjeve joushtarake vdekjeprurëse, ("Fletorja Zyrtare" numër 101/2013), në pikën I. shtohet pika I.a:

"I.a

Me këtë vendim në rendin juridik të Republikës së Kroacisë, miratohen direktivat si vijon:

1. Direktiva 2009/43/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 6 majit 2009 për thjeshtëzimin e kushteve për transferimin e produkteve për mbrojtjen brenda Komunitetit (SLL 146, 10. 6. 2009.);
2. Direktiva e Komisionit 2012/47/BE e 14 dhjetorit 2012 që ndryshon Direktivën 2009/43/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për regjistrimin e produkteve për mbrojtjen (SL L 31, 31. 1. 2013.);
3. Direktiva e Komisionit 2014/18/BE e 29 janarit 2014 që ndryshon Direktivën 2009/43/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për produktet e mbrojtjes (SL L 40/20, 11. 2. 2014.)."

II.

Në pikën II. Lista e produkteve për mbrojtjen në shtojcën II zëvendësohet me listën e re të produkteve për mbrojtjen.

III.

Në pikën III fjalët: "Zyra shtetërore për politikën tregtare" zëvendësohet me fjalët: "Ministria Punëve të Jashtme dhe Çështjeve Evropiane"

IV.

Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit të tij në "Fletoren Zyrtare".

Klasa: 022-03/14-04/147

Në numrin: 50301-05/18-14-2

Zagreb, 8 maj 2014.

Kryetari

Zoran Milanović,
d.v.

SHTOJCA II.

LISTA E PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN:

Shënim 1: Fjalët në "thonjëza" janë përkufizime. Lidhen me "përkufizimet e listës" që i bashkëlidhet kësaj liste.

Shënim 2: Në disa raste, kimikatet janë paraqitur me emër dhe numër CAS. Lista zbatohet për kimikate me formulë strukturore të ngjashme (përfshirë hidratet), pavarësisht nga emri ose numri CAS. Numrat CAS janë paraqitur për të identifikuar më lehtë kimikate të caktuara, pavarësisht nga nomenklatura. Numrat CAS nuk mund të përdoren si mjete i vetëm identifikues, sepse disa forma të këtyre kimikateve kanë numra të ndryshëm CAS, por edhe përbërjet që përmbajnë këtë kimikat mund të kenë numra të ndryshëm CAS.

ML1 Armët me tytë të pavjaskuar me kalibër nën 20 mm, armët e tjera dhe armët automatike me kalibër 12,7 mm (kalibër 0,50 inç) ose më të vogël, si dhe aksesoret vijues dhe komponentët e projektuar për to:

Shënim: ML1 zbatohet për:

a. Armët e synuara posaçërisht për ndezjen e të ashtuquajturit municion manovër, të cilat nuk mund të ndezin predhë;

b. Armët të synuara posaçërisht për gjuajtjen e predhës në distanca deri 500 metra, pa mbushje plasëse ose lidhje komunikuese;

c. Armët me municion me ndezje anësore, të cilat janë gjysmë automatike.

a. Pushkët dhe armët e zjarrit të kombinuara, armët e zjarrit të dorës, automatikët, armët automatike të shkurtra dhe armët e zjarrit me shumë tyta;

Shënim: ML1.a. nuk përfshin sa më poshtë:

a. Pushkët dhe armët e kombinuara të prodhuara përpara vitit 1938;

b. Riprodhimet e pushkëve dhe armëve të kombinuara, origjinalet e të cilave janë prodhuar përpara vitit 1890;

c. Armët e zjarrit të dorës, armët me shumë tyta dhe mitralozët e prodhuar përpara vitit 1890 dhe riprodhimet e tyre;

b. Armët me tytë të pavjaskuar, si vijon:

1. Armët me tytë të pavjaskuar të synuara posaçërisht për qëllime ushtarake;

2. Armët e tjera me tytë të pavjaskuar si vijon:

a. Armët plotësisht automatike;

b. Armët gjysmautomatike ose me mekanizëm rrëshqitës, me rimbushje (mitraloz);

Shënim: ML1.b. nuk përfshin sa më poshtë:

a. Armët me tytë të shkurtër të prodhuara përpara vitit 1938;

b. Riprodhimet e armëve me tytë të shkurtër, origjinali i të cilëve është prodhuar përpara vitit 1890;

c. Armët me grykë të shkurtër që përdoren për gjueti ose sport. Këto armë nuk duhet të përdoren veçanërisht për përdorim ushtarak dhe as nuk duhet të jetë automatike;

d. Armët me tytë të shkurtër të prodhuara posaçërisht për:

1. Vrasjen e kafshëve shtëpiake;

2. Vënien në gjumë të kafshëve;

3. Testimet sizmike;

4. Hedhjen e predhave industriale; ose

5. Pajisjet e improvizuara plasëse (IED).

Shënime të rëndësishme: Për pajisjet për neutralizim, shih ML4 dhe paragrafin 1A006 në listën e mallrave me qëllim të dyfishtë të BE-së.

c. armët që përdorin municion pa gëzhjojë;

d. karikatorët e heqshëm të fishekëve, silenciatorët ose moderatorët, pajisjet e posaçme për montim në pushkë, shënjestrat optike dhe zbutësit e flakës të përcaktuara në ML1.a., ML1.b. ose ML1.c.

Shënim: ML1.d. nuk zbatohet për shënjestrat optike për armët pa përpunim elektronik të figurës dhe shënjestër me zmadhim katërfish ose më të vogël, me kusht që të mos jenë përpunuar ose modifikuar veçanërisht për qëllime ushtarake.

ML2 Armët me tytë të pavjaskuar me kalibër nën 20 mm, armët e tjera ose armët me kalibër më të madh se 12,7 mm (kalibër 0,50 inç), gjuajtësit dhe pajisjet në vijim dhe komponentët e projektuara posaçërisht për to:

a. armët, topat, minahedhësit, armët antitanke, raketahedhësit, flakëhedhësit ushtarakë, pushkët, armët me tytë të pavjaskuar dhe pajisjet për fshehjen e gjurmës;

Shënim 1: ML2.a. përfshin injektorët, pajisjen matëse, rezervuar dhe komponentë të tjerë të projektuar posaçërisht për përdorimin me mbushje të lëngshme për cilëndo pajisje të paraqitur në ML2.a.

Shënim 2: ML2.a. nuk zbatohet për armët e mëposhtme:

a. Pushkët, armët me tytë të pavjaskuar dhe armët e kombinuara të prodhuara përpara vitit 1938;

b. Riprodhimet e pushkëve, armëve me tytë të pavjaskuar dhe armëve të kombinuara, origjinalet e të cilave janë prodhuar përpara vitit 1890;

c. Armët, topat dhe minahedhëset e prodhuara përpara vitit 1890;

d. Armët me tytë të shkurtër që përdoren për gjueti ose sport. Këto armë nuk duhet të jenë të

projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak dhe as nuk duhet të jenë automatike;

e. Armët me tytë të pavjaskuar të projektuara posaçërisht për:

- 1. Vrasjen e kafshëve shtëpiake;*
- 2. Vënien në gjumë të kafshëve;*
- 3. Testime sizmike;*
- 4. Hedhjen e predhave industriale; ose*
- 5. Pajisje të improvizuara plasëse (IED).*

Shënime të rëndësishme: Për pajisjet për neutralizim shih ML4 dhe paragrafin 1A006 në listën e mallrave me qëllim të dyfishtë të BE-së.

f. Predhahedhëset portative të projektuara posaçërisht për hedhje predhash pa mbushje me lëndë plasëse ose lidhje komunikuese, në distanca mbi 500 m;

b. Hedhës tymues, gazi dhe piroteknik ose gjeneratorë të projektuar posaçërisht ose të modifikuar për përdorim ushtarak;

Shënim: ML2.b nuk zbatohet për pistoletat sinjalizuese.

c. shënjestrat për armët dhe mbajtësit e shënjestrave të cilat:

- 1. janë projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak; dhe*
- 2. janë projektuar posaçërisht për armët e paraqitura në ML2.a;*

d. trekëmbëshi dhe karikatorët e heqshëm të fishekëve të prodhuar posaçërisht për armët e paraqitura në ML2.a.

ML3 Municioni dhe ndezësit e municionit si vijon, dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to:

- a. municion për armët e përfshira në ML1, ML2 ose ML12;*
- b. pajisje për përshtatjen e ndezësit për municionin e paraqitur në ML3.a.*

Shënim 1: ML3 përfshin komponentët e mëposhtëm të projektuar posaçërisht:

a. komponentët metalikë ose plastikë, siç janë kapsulat, këllëfi i fishekëve, unaza drejtuese dhe pjesët metalike të municionit;

b. pajisjet e sigurisë dhe të armatosjes, siguresat, sensorët dhe pajisjet iniciuese;

c. mbushje energjetike për një shkrepje;

d. gëzhojat e djegshme për mbushje;

e. municionet thërrmuese, duke përfshirë bombat, minat dhe predhat e përfshira në objektiv.

Shënim 2: ML3.a. nuk zbatohet për municionet gëzhoja e të cilave është e mbyllura pa predhën (të

ashtuquajtura si "yll bosh") dhe as të ashtuquajturat municione manovër me baruti me vrira.

Shënim 3: ML3.a. nuk zbatohet për fishekët e projektuar posaçërisht për ndonjë nga qëllimet e mëposhtme:

- a. Sinjalizim;*
- b. Trembje zogjsh; ose*
- c. Djegie fitili në pusët e naftës.*

ML4 Bombat, silurët, raketat, predhat, pajisjet dhe mbushjet e tjera shpërthyese, aksesorët e mëposhtëm të projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak, si dhe komponentët e projektuar për sa vijon:

Shënim i rëndësishëm 1: Për pajisjen për kërkim de navigim, shih ML11.

Shënim i rëndësishëm 2: Për sistemet mbrojtëse të avionëve nga raketat (AMPS), shih ML4.c.HR

a. bombat, silurët, granatat, bombolat e tymit, raketa, minat, mbushjet për shpërthim në thellësi, mbushjet për shembje dhe pajisjet për asgjësim, pajisjet "piroteknike", fishekët e simulatorët (p.sh., pajisjet që simulojnë karakteristikat e cilësdo prej këtyre pajisjeve), të projektuara për përdorim ushtarak;

Shënim: ML4.a.përfshin:

- a. Granatat tymuese, bombat ndezëse dhe pajisjet shpërthyese;*
- b. Hundëza e predhave të raketave dhe e majave të predhave ajrore, të cilat mund të kthehen në atmosferë.*
- b. Pajisjet të cilat:*
 - 1. janë projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak; dhe*
 - 2. janë prodhuar posaçërisht për "aktivitetet" e lidhura me:*
 - a. artikujt që janë objekt i kontrollit sipas ML4.a.; ose*
 - b. pajisjet e improvizuara shpërthyese (IED).*

Shënim teknik:

Për qëllimet e ML4.b.2. "aktivitetet" lidhen me administrimin, ndezjen, hapjen, kontrollin, boshatisjen, shpërthimin, aktivizimin, aktivizimin me një rezultat pune, saldimin, bllokimin, heqjen, zbulimin dhe ndërhyrjen.

Shënim 1: ML4.a. përfshin:

- a. Pajisjet e lëvizshme për shndërrimin e gazit në lëng, të cilat mund të prodhojnë 1000 ose më shumë kg gaz të lëngshëm në ditë;*
- b. Kabllon elektrike pluskuese për pastrimin e minave magnetike.*
- c. Sistemet për mbrojtjen e avionëve nga raketa (AMPS).*

Shënim: ML4.c. nuk përfshin AMPS-të, të cilat kanë:

a. cilindro nga sensorët për paralajmërimin e pranisë së raketave:

1. sensorë pasivë me përgjigje të shkëlqyer midis 100 dhe 400 mm; ose

2. sensorë pulsues aktivë Doppler për paralajmërim në lidhje me raketat;

b. sisteme për krijimin e kundërmasave;

c. fishekzjarrë për "futjen në grackë" të raketave tokë-ajër, të cilat kanë gjurmë të dukshme dhe rreze infra të kuqe; dhe

d. janë instaluar në "avionë civilë", tek të cilët:

1. AMPS është funksionale vetëm në "avionë civilë" të caktuar ku është instaluar AMPS e posaçme dhe për të cilët është dhënë një nga dokumentet vijues:

a. një vërtetim civil; ose

b. dokumentin përkatës të njohur nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO);

2. AMPS-të disponojnë një masë mbrojtëse për pengimin e aksesit të paautorizuar në "softuer"; dhe

3. AMPS-të përfshijnë një mekanizëm aktiv që e bën sistemin jofunksional kur hiqet nga "avioni civil" në të cilin është instaluar.

ML5 Pajisjet për kontrollin e zjarrit dhe pajisjet sinjalizuese dhe paralajmërues dhe sistemet e ngjashme, pajisjet e testimi, shënjestrimin dhe kundërmasës, si dhe komponentët dhe aksesorët e projektuar posaçërisht për sa më lart:

a. shënjestrat e armëve, kompjuterët për bombardim, sistemet e drejtimit të armëve dhe sistemet e kontrollit të armës;

b. sistemet për caktimin e pozicionit të shënjestrës, tregimin dhe përcaktimin e distancës deri te shënjestra, mbikëqyrjen ose monitorimin; pajisja për diktimin, grumbullimin e të dhënave, njohjen dhe identifikimin; dhe pajisja për instalimin e sensorit;

c. pajisjen e veprimit kundërelektronik, të projektuar për armët e parashikuara në ML5.a. ose ML5.b.;

Shënim: Për qëllimet e ML5.c, pajisja e veprimit kundërelektronik përfshin edhe pajisjen e zbulimit.

d. pajisjen e testimi në terren ose shënjestrimin, të projektuar posaçërisht për mjetet e paraqitura në ML5.a, ML5.b ose ML5.c.

ML6 Mjetet motorike tokësore dhe komponentët e mëposhtëm:

Shënime të rëndësishme: Për pajisjen për kërkim de navigim, shih ML11.

a. mjetet motorike tokësore dhe komponentët e tyre të prodhuar dhe modifikuar posaçërisht për nevoja ushtarake;

Për qëllimet e ML6.a, termi mjet motorik tokësor përfshin edhe rimorkiot.

b. mjete të tjera motorike tokësore dhe komponentët e mëposhtëm:

1. Automjete të cilat:

a. janë prodhuar ose pajisur me materiale ose komponentë që ofrojnë mbrojtje balistike të nivelit III (sipas normave NIJ 0108. 1 shtator 1985 ose normës së krahasueshme të brendshme) ose më shumë;

b. kanë transmision që mundëson lëvizje të njëkohshme në rrotat e përparme dhe të pasme, duke përfshirë automjetet të cilat për, shkak të kapacitetit të madh, kanë rrota shtesë pavarësisht nëse janë ose jo në lëvizje;

c. kanë masë bruto të automjetit (GVWR) më të madhe se 4500 kg; dhe

d. janë prodhuar ose përpunuar për të lëvizur jashtë rrugëve;

2. Komponentët të cilët:

a. janë projektuar plotësisht për mjetet motorike të paraqitura në ML6.b.1; dhe

b. ofrojnë mbrojtje balistike të nivelit III (sipas normave NIJ 0108. 1 shtator 1985 ose normës së krahasueshme të brendshme) ose më shumë;

Shënime të rëndësishme: Shih edhe ML13.a.

Shënim 1: ML6.a. përfshin:

a. tanket dhe mjete motorike ushtarake të tjera, si dhe mjete motorike të cilat janë pajisur me mbajtës armatimi dhe pajisje për vendosjen e minave dhe hedhjen e predhave të paraqitura në ML4;

b. mjetet e blinduara;

c. mjetet amfibe dhe mjetet motorike për sipërfaqet e ujërave të thella;

d. mjetet për tërheqje dhe mjetet për tërheqje e transport ose sistem armatimi, si dhe pajisjet e lidhura me këtë pajisje për trajtimin e ngarkesës.

Shënim 2: Modifikimi i mjetit motorik tokësor për përdorim të jashtëm të paraqitur në ML6.a. nënkupton ndryshimin strukturor, mekanik ose elektrik që përfshin të paktën një komponent të projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak. Këta komponentë përfshijnë:

a. pajisjen me goma të mbushura me ajër, për të ofruar mbrojtje nga predhat dhe mundësi udhëtimi edhe kur janë bosh;

b. mbrojtjen e blinduar të pjesëve vitale (p.sh. të serbatorit të karburantit ose kabinës së mjetit);

c. përforcimet e posaçme dhe mbajtëset e armëve;

d. dritat për udhëtim natën.

Shënim 3. ML6 nuk zbatohet për mjetet motorike civile të prodhuara ose të modifikuara për transportimin e parave ose sendeve me vlerë.

Shënim 4: ML6 nuk zbatohet për automjetet të cilat:

a. janë prodhuar përpara vitit 1946;

b. nuk përfshijnë mallrat e paraqitura në listën e përbashkët të mallrave me qëllim të dyfishtë pas vitit 1945, përveç riprodhimit të komponentëve origjinalë ose pjesëve shtesë të makinave; dhe

c. nuk përfshijnë armët e paraqitura në ML1, ML2 ose ML4, përveç rastit kur ato janë të papërdorshme dhe nuk mund të përdoren për qitje me predha;

ML7 Agjentët toksikë kimikë dhe biologjikë, "agjentët për kontrollin e trazirave", materialet radioaktive dhe pajisjet, komponentët e materialet e lidhura me to si më poshtë:

a. agjentët biologjikë dhe materialet radioaktive të përshtatura për përdorim në luftë", për asgjësimin e njerëzve dhe kafshëve, pajisjeve, kulturave ose ambientit;

b. agjentët për luftën kimike, duke përfshirë:

1. Agjentët nervorë për luftën kimike:

a. O-alkil (i barabartë ose më i vogël se C10, duke përfshirë cikloalkilin), alkil (metil, etil, n-propil ose izopropil) – fosfonofluoridat, siç janë:

sarina (GB): O-izopropil metilfosfonofluoridat (CAS 107-44-8); dhe

soman (GD): O-pinakolil metilfosfonofluoridat (CAS 96-64-0);

b. O-alkil (i barabartë ose më i vogël se C10, duke përfshirë cikloalkil), N, N- dialkil (metil, etil, n-propil ose izopropil) – fosfoamidocijanidatet, siç janë:

gabun (GA): O-etil N, N-dimetilfosforamidocijanidat (CAS 77-81-6);

c. O-alkil (H i barabartë ose më i vogël se C10, duke përfshirë cikloalkil), S-2- dialkil (metil, etil, n-propil ose izopropil) – aminoetil alkil (metil, etil, n-propil ose izopropil) fosfonotiolate dhe kripërat përkatëse fosfonotiolatet dhe të pretonuar, siç janë:

VX: O-etil S-2-diizopropilaminoetil metil fosfonotiolat (CAS 50782-69-9);

2. agjentët kimikë për luftë kimike:

a. helmet e squfurit, siç janë:

1. 2-kloroetilklorometilsulfid (CAS 2625-76-5);

2. bis (2-kloroetil) sulfid (CAS 505-60-2);

3. bis (2-kloroetiltio) metan (CAS 63869-13-6);

4. 1,2-bis (2-kloroetiltio) etan (CAS 3563-36-8);

5. 1,3-bis (2-kloroetiltio) -n-propan (CAS 63905-10-2);

6. 1,4-bis (2-kloroetiltio) -n-butan (CAS 142868-93-7);

7. 1,5-bis (2-kloroetiltio) -n-pentan (CAS 142868-94-8);

8. bis (2-kloroetiltiometil) eter (CAS 63918-90-1);

9. bis (2-kloroetiltioetil) eter (CAS 63918-89-8);

b. luizitet, të tilla si:

1. 2-klorovinildikloroarsin (CAS 541-25-3);

2. tris (2-klorovinil) arsinë (CAS 40334-70-1);

3. bis (2-klorovinil) kloroarsinë (CAS 40334-69-8);

c. helmet e azotit, të tilla si:

1. HN1: bis (2-kloroetil) etilamina (CAS 538-07-8);

2. HN2: bis (2-kloroetil) metilamina (CAS 51-75-2);

3. HN3: tris (2-kloroetil) amina (CAS 555-77-1);

3. agjentët për neutralizim në luftëra kimike, siç është:

a. 3-kvinuclidinil benzilat (BZ) (CAS 6581-06-2);

4. defoliantët e projektuar për luftë kimike, siç është:

a. butil 2-kloro-4-fluorofenoksiacetat (LNF);

b. acid 2,4,5 triklorofenoksiacetik (CAS 93-76-5) i përzier me acid 2,4 diklorofenoksiacetik (CAS 94-75-7) (agjentë portokalli (CAS 39277-47-9)); HR 11.2.2014.

c. prekursorët binarë dhe prekursorët kryesorë të synuar për luftëra kimike, si vijon:

1. alkil (metil, etil, n-propil ose izopropil) fosfonil difluoridi, siç është:

DF: metil fosfonildifluorid (CAS 676-99-3);

2. O-alkil (H i barabartë ose më i vogël se C10, përfshirë cikloalkil), O-2- dialkil (metil, etil, n-propil ose izopropil) – aminoetil alkil (metil, etil, n-propil ose izopropil) fosfonitet dhe kriperat përkatëse të alkiluara dhe të pretonuara, siç janë:

QL: O-etil-2-di-izopropilaminoetil metilfosfonit (CAS 57856-11-8);

3. klorosarinë: O-izopropil metilfosfonokloridat (CAS 1445-76-7);

4. klorosomanë: O-pinakolil metilfosfonokloridat (CAS 7040-57-5);

d. "agjentët për kontrollin e trazirave", kimikate përbërëse aktive dhe kombinimet e tyre, duke përfshirë:

1. α -bromobenzenacetoniitril, (cianid bromobenzil) (CA) (CAS 5798-79-8);

2. [(2-klorofenil) metilen] propanedinitril, (o-klorobenzilidenemalononitril (o-klorobenzalmalononitril) (CS) (CAS 2698-41-1);

3. 2-kloro-1-feniletanon, fenilacil kloridom (ω -kloroacetofenon) (CN) (CAS 532-27-4);

4. dibenz-(b,f)-1,4-oksazefin (CR) (CAS 257-07-8);
5. 10-kloro-5,10-dihidrofenasazinë, (klorur fenarsazine), (adamsit), (DM) (CAS 578-94-9);
6. N-nonanoilmorfolinom, (MPA) (CSA 5299-64-9);

Shënim 1: ML7.d. nuk zbatohet për agjentët lotsjellës ose "agjentët për kontrollin e trazirave", të paketuara veçantë për qëllime vetëmbrojtjeje.

Shënim 2: ML7.d. nuk zbatohet për përbërësit aktivë të kimikateve dhe kombinimit të tyre të identifikuar dhe paketuara për prodhimin e ushqimit ose për qëllime mjekësore.

e. pajisjet e prodhuara ose të modifikuara posaçërisht për përdorim ushtarak, të prodhuara ose modifikuara posaçërisht për përhapjen e secilës prej tyre dhe për komponentët e synuar posaçërisht për to:

1. materialet ose agjentët e paraqitur në ML7.a., ML7.b. ose ML7.d.; ose
2. agjentët për luftë kimike, të përbërë nga prekursorët e paraqitur në ML7.c;

f. pajisjet mbrojtëse dhe kundër kontaminimit, të prodhuara posaçërisht ose të modifikuara për përdorim ushtarak, si dhe komponentët dhe përzierjet kimike të mëposhtme:

1. pajisjet e përpunuara ose të modifikuara posaçërisht për mbrojtjen nga materialet e paraqitura në ML7.a., ML7.b. ose ML7.d. dhe komponentët e synuar posaçërisht për të;
2. Pajisjet e prodhuara posaçërisht ose të modifikuara për dekontaminim e objekteve të materialeve të kontaminuar të paraqitur në ML7.a. ose ML7.b. dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to;
3. Përzierjet kimike të zhvilluara ose të krijuara posaçërisht për dekontaminimin e objekteve të materialeve të kontaminuara që paraqiten në ML7.a. ose ML7.b.;

Shënim: ML7.f.1. përfshin:

a. njësitë ftohëse të prodhuara ose të modifikuara posaçërisht për filtrim kimik ose biologjik ose bërthamor;

b. veshjet mbrojtëse.

Shënime të rëndësishme: Për maskat kundër gazit për civilët, pajisjet mbrojtëse dhe dekontaminuese, shih edhe 1A004 në listën e mallrave me qëllim të dyfishtë të BE-së.

g. Pajisjet e prodhuara ose të modifikuara posaçërisht për përdorim ushtarak, të prodhuara ose modifikuara për zbulimin ose identifikimin e materialeve të specifikuar në ML7.a., ML7.b. ose ML7.d, dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to;

Shënim: ML7.g. nuk zbatohet për dozimetrat e dozimetrisë personale.

Shënime të rëndësishme: Shih edhe 1A004 në listën e mallrave me qëllim të dyfishtë të BE-së.

h. "biopolimeret" e prodhuar ose të përpunuar posaçërisht për zbulimin ose identifikimin e agjentëve për luftë kimike, që specifikohen në ML7.b. dhe kulturave të stacioneve të posaçme që merren me prodhimin e tyre;

i. "biokatalizatorët" për dekontaminimin ose shpërbërjen e agjentëve të luftës kimike dhe përbërësit e

tyre biologjike, si më poshtë:

1. "biokatalizatorët" e prodhuar posaçërisht për dekontaminim ose për shpërbërjen e agjentëve të luftës kimike që i nënshtrohen kontrollit sipas ML7.b., të cilët janë rezultat i përzgjedhjes laboratorike të drejtuar ose manipulimit gjenetik të sistemeve biologjike;
2. sistemet biologjike të cilat përmbajnë informacione gjenetike specifike për prodhimin e "biokatalizatorëve" të specifikuar në ML7.i.1., si vijon:
 - a. "vektorët ekspresion";
 - b. viruset;
 - c. kultura qelizore.

Shënim 1: ML7.b. dhe ML7.d. nuk zbatohet për sa më poshtë:

- a. klorur cianogjeni (CAS 506-77-4). Shih 1C450.a.5. në listën e mallrave me qëllim të dyfishtë të BE-së;
- b. acid hidrocianik (CAS 74-90-8);
- c. klor (CAS 7782-50-5);
- d. klorur karbonili (fosgjen) (CAS 75-44-5). Shih 1C450.a.4. në listën e mallrave me qëllim të dyfishtë të BE-së;
- e. difosgjen (triklorometil-kloroformat) (CAS 503-38-8);
- f. Nuk përdoret që nga viti 2004;
- g. bromid ksilili, orto: (CAS 89-92-9), meta: (CAS 620-13-3), para: (CAS 104-81-4);
- h. bromid benzili (CAS 100-39-0);
- i. jodid benzili (CAS 620-05-3);
- j. bromo aceton (CAS 598-31-2);
- k. bromid cianogjeni (CAS 506-68-3);
- l. bromo metiletiketoni (CAS 816-40-0);
- m. kloroaceton (CAS 78-95-5);
- n. etil jodoacetat (CAS 623-48-3);
- o. jodo aceton (CAS 3019-04-3);
- p. kloropikrinë (CAS 76-06-2). Shih 1C450.a.7. në listën e mallrave me qëllim të dyfishtë të BE-së;

Shënim 2: Kulturat e qelizave dhe përbërjet biologjike të paraqitura në ML7.h., ML7.i.2. bëjnë përjashtim dhe secila prej tyre nuk lidhet me qelizat dhe sistemet biologjike për qëllime civile, sikurse janë bujqësia, farmacia, mjekësia, veterinaria, ambienti, trajtimi i mbetjeve ose industria ushqimore.

ML8 "Materialet energjetike" dhe indet përkatëse të mëposhtme:

Shënim i rëndësishëm 1: Shih edhe IC011 në listën e mallrave me qëllim të dyfishtë të BE-së.

Shënim i rëndësishëm 2: Për mbushjen dhe pajisjet, të shihet ML4 dhe IA008 në listën e mallrave me qëllim të dyfishtë të BE-së.

Shënime teknike

1. Për qëllimet e ML8, përzierje i referohet një përbërjeje prej dy ose më shumë substancave, ku të paktën njëra prej tyre i nënshtrohet kontrollit sipas pikave ML8.

2. Çdo substancë e paraqitur në nënpikat ML8 kontrollohet sipas kësaj liste, madje edhe kur përdoret për qëllime të ndryshe nga ato të specifikuar (p.sh. TAGN përdoret kryesisht si lëndë plasëse, por mund të përdoret edhe si karburant edhe si oksidues).

a. "lëndët plasëse" në vijim dhe përzierjet e tyre:

1. ADNBF (aminodinitrobenzofuroksan ose 7-amino-4,6-dinitrobenzofurazan-1-oksidi) (CAS 97096-78-1);

2. BNCP (cis-bis (5-nitrotetrazolato) tetra amin-kobalt (III) perklorat) (CAS 117412-28-9);

3. CL-14 (diamino dinitrobenzofuroksan ose 5,7-diamino-4,6-dinitrobenzofurazan-1-oksidi) (CAS 117907-74-1);

4. CL-20 (HNIW ose heksanitroheksazaizovurcitan) (CAS 135285-90-4); klatrat prej CL-20 (për "prekursorët" e tyre, shih edhe ML8.g.3. i g.4.);

5. CP (2-(5-cianotetrazolato) penta amin-kobalt (III) perklorat) (CAS 70247-32-4);

6. DADE (1,1-diamino-2,2-dinitroetilen, FOX7) (CAS 145250-81-3);

7. DATB (diaminotrinitrobenzen) (CAS 1630-08-6);

8. DDFP (1,4-dinitrodifurazanopiperazin);

9. DDPO (2,6-diamino-3,5-dinitropirazin-1-oksidi, PZO) (CAS 194486-77-6);

10. DIPAM (3,3'-diamino-2,2',4,4',6,6'-heksanitrobifenil ose dipikramid) (CAS 17215-44-0);

11. DNGU (DINGU ose dintroglikoluril) (CAS 55510-04-8);

12. furazanët e mëposhtëm:

a. DAAOF (diaminoazoksifurazan);

b. DAAzF (diaminoazofurazan) (CAS 78644-90-3);

13. HMX dhe derivatet (shih gjithashtu ML8.g.5. për "materialet e papërpunuara" të tyre, si vijon:

a. HMX (Ciklotetrametilentetranitraminë, oktahidro-1,3,5,7-tetranitro-1,3,5,7-tetrazinë, 1,3,5,7-tetranitro-1,3,5,7-tetrazaciklooktan, oktojen) (CAS 2691-41-0);

b. Analogët e difluoroaminuar të HMX;

- c. K-55 (2,4,6,8-tetranitro-2,4,6,8-tetraazabicyclo [3,3,0]-oktanon-3,tetranitrosemiglikuril ose keto-bicyklik HMX) (CAS 130256-72-3);
14. HNAD (heksanitroadamantan) (CAS 143850-71-9);
15. HNS (heksanitrostilben) (CAS 20062-22-0);
16. imidazol, si më poshtë:
- a. BNNII (oktahidro-2,5-bis(nitroimino)imidazo[4,5-d]imidazol);
- b. DNI (2,4-dinitroimidazol) (CAS 5213-49-0);
- c. FDIA (1-fluoro-2,4-dinitroimidazol);
- d. NTDNIA (N-(2-nitrotriazol)-2,4-dinitroimidazol);
- e. PTIA (1-pikril-2,4,5-trinitroimidazol);
17. NTNMH (1-(2-nitrotriazol)-2-dinitrometilen hidrazinë);
18. NTO (ONTA ose 3-nitro-1,2,4-triazol-5-një) (CAS 932-64-9);
19. polinitrokubane me mbi katër grupe nitro;
20. PYX (2,6-bis(pikrilamino)-3,5-dinitropiridinë) (CAS 38082-89-2);
21. RDX dhe derivatet e mëposhtme:
- a. RDX (ciklotrimetilenetrinitraminë, ciklonit, T4, heksahidro-1,3,5-trinitro-1,3,5-triazinë, 1,3,5-trinitro-1,3,5-triaza-cikloheksan, hekgogjen) (CAS 121-82-4);
- b. keto-RDX (K-6 ili 2,4,6-trinitro-2,4,6-triazacikloheksanon) (CAS 115029-35-1);
22. TAGN (triaminoguanidinënitrat) (CAS 4000-16-2);
23. TATB (triaminotrinitrobenzen) (CAS 3058-38-6) (për "prekursorët" e tyre, shih edhe ML8.g.7.);
24. TEDDZ (3,3,7,7-tetrabis(difluoraminë) oktahidro-1,5-dinitro-1,5-diazocinë);
25. Tetrazole si më poshtë:
- a. NTAT (nitrotriazol aminotetrazol);
- b. NTNT (1-N-(2-nitrotriazol)-4-nitrotetrazol);
26. tetril (trinitrofenilmetilnitraminë) (CAS 479-45-8);
27. TNAD (1,4,5,8-tetranitro-1,4,5,8-tetraazadekalinë) (CAS 135877-16-6) (për "prekursorët" e tyre, shih edhe ML8.g.6.);
28. TNAZ (1,3,3-trinitroazetidinë) (CAS 97645-24-4) (për "prekursorët" e tyre, shih edhe ML8.g.2.);
29. TNGU (SORGUYL ili tetranitroglikoluril) (CAS 55510-03-7);

30. TNP (1,4,5,8-tetranitro-piridazino[4,5-d] piridazinë) (CAS 229176-04-9);
31. triazinat, si vijon:
- DNAM (2-oksi-4,6-dinitroamino-s-triazinë) (CAS 19899-80-0);
 - NNHT (2-nitroimino-5-nitro-heksahidro-1,3-5-triazinë) (CAS 130400-13-4);
32. Triazolet, si vijon:
- 5-azido-2-nitrotriazol;
 - ADHTDN (4-amino-3,5-dihidrazino-1,2,4-triazol dinitramidë) (CAS 1614-08-0);
 - ADNT (1-amino-3,5-dinitro-1,2,4-triazol);
 - BDNTA ([bis-dinitrotriazol] aminë);
 - DBT (3,3'-dinitro-5,5-bi-1,2,4-triazol) (CAS 30003-46-4);
 - DNBT (dinitrobistriazol) (CAS 70890-46-9);
 - Nuk përdoret që nga viti 2010;
 - NTDNT (1-N-(2-nitrotriazolo) 3,5-dinitrotriazol);
 - PDNT (1-pikril-3,5-dinitrotriazol);
 - TACOT (tetranitrobenzotriazolobenzotriazol) (CAS 25243-36-1);
33. Lëndët plasë që nuk janë përfshirë në ML8.a. dhe që nuk kanë:
- shpejtësi shpërthimi më të madhe se 8700 m/s në dendësi maksimale; ose
 - presion shpërthimi mbi 34 GPa (340 kbar);
34. Lëndët plasëse organike, të cilat nuk janë paraqitur në ML8.a. dhe nuk:
- arrijnë presion shpërthimi të paktën 25 GPa (250 kbar); dhe
 - janë të paktën 5 minuta të qëndrueshme në temperatura prej të paktën 523 K (250 °C);
- b. "lëndët djegëse", si më poshtë:
- Çdo "lëndë djegëse" e ngurtë e kategorisë 1.1. me fuqi shtytëse teorike të specifikuar nga Kombet e Bashkuara (OKB) (në kushtet standarde) mbi 250 sekonda për përbërjet e pametalizuara ose mbi 270 sekonda për përbërjet e alumizuara;
 - Çdo "lëndë djegëse" e ngurtë e kategorisë 1.3. me fuqi shtytëse teorike të specifikuar nga Kombet e Bashkuara (OKB) (në kushtet standarde) mbi 230 sekonda për përbërjet e pahalogjenizuara, mbi 250 sekonda për përbërjet e pametalizuara ose mbi 266 sekonda për përbërjet e alumizuara;
 - "lëndët djegëse" që kanë fuqi konstante mbi 1200 kJ/kg;

4. "lëndët djegëse" që mund të mbajnë një shpejtësi të qëndrueshme lineare djegieje prej më shumë se 38 mm/s në kushte standarde (matur në formën e një tufe të frenuar teke) nën trysni 6,89 MPa (68,9 bar) dhe 294 K (21°C);

5. "lëndët djegëse" të modifikuara me bazë dyshe elastomeri (EMCDB) me koeficient hapje në trysni maksimale më të mbi 5% në 233 K (-40 °C);

6. Çdo "lëndë djegëse" që përmban substancat e paraqitura në ML8.a.;

7. "lëndët djegëse" të cilat nuk janë paraqitur në listën e përbashkët të mallrave me karakter ushtarak të BE-së dhe të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak;

c. karburantet dhe substancat që kanë lidhje "piroteknike" dhe përzierjet e tyre:

1. Karburant avionësh të formuluar posaçërisht për qëllime ushtarake;

Shënim: Karburantet e avionëve që specifikohen në ML8.c.1. janë produkte të gatshme, por jo përbërësit e tyre.

2. alan (hidrur alumini) (CAS 7784-21-6);

3. karboranet; dekaborani (CAS 17702-41-9); pentaboranët (CAS 19624-22-7 dhe 18433-84-6) dhe derivatet e tyre;

4. hidrazina dhe derivatet e mëposhtme (për oksidimin e derivateve hidrozine, shih edhe ML8.d.8. dhe d.9.):

a. hidrazinë në përqendrim (CAS 302-01-2) prej të paktën 70%;

b. monometil hidrazine (CAS 60-34-4);

c. hidrazinl dimetili simetrike (CAS 540-73-8);

d. hidrazinë dimetili josimetrike (CAS 57-14-7);

Shënim: ML8.c.4.a. nuk zbatohet për "përzierjet" hidrozine, të krijuara posaçërisht për mbrojtjen nga korrozioni.

5. Lëndët djegëse prej metali në formën e grimcave, pavarësisht nëse janë ose jo sferike, të automatizuara, sferike, të petëzuara ose të ngrira, të prodhuar nga materiale 99% ose më shumë e të cilave përbëhet nga një prej elementeve të mëposhtme;

a. metalet dhe përzierjet e tyre si vijon:

1. berilium (CAS 7440-41-7) me madhësi grimcash nën 60 µm;

2. pluhur hekuri (CAS 7439-89-6) me madhësi grimcash mbi 3 µm, prodhuar nga reduktimi i oksidit të hekurit me hidrogjen;

b. përzierjet që përmbajnë një nga sa vijon:

1. zirkon (CAS 7440-67-7), magnez (CAS 7439-95-4) ose aliazhe të tyre me madhësi grimce më të vogël se 60 µm; ose

2. bor (CAS 7440-42-8) ose karbid bori (CAS 12069-32-8) me pastërti minimalisht 85% dhe

madhësi grimce mbi 60 µm;

Shënim 1: ML8.c.5. lidhet me lëndët plasëse dhe lëndët djegëse që përmbajnë metale ose aliazhe, pavarësisht nëse janë metale ose aliazhe të ndërtuara në alumin, magnez, zinkon ose berilium.

Shënim 2: ML8.c.5.b. lidhet vetëm me lëndët djegëse prej metali në formë grimcash, kur janë të përzierja me substanca të tjera për të formuar përzierje për qëllime ushtarake, siç janë sistemet për lëndët e djegëse të lëngëta ose të dendura, lëndët djegëse të ngurta ose përzierjet piroteknike.

Shënim 3: ML8.c.5.b.2. nuk zbatohet për borin ose karbitin e borit të pasuruar me bor -10 (20% ose më shumë të përbërjes së përgjithshme të borit-10).

6. Materialet ushtarake që përmbajnë ngurtësues për lëndët djegëse hidrokarbure të formuluar posaçërisht për përdorim në flakëdhësit ose municion ndezës siç janë stearatet metalik ose palmatet (p.sh. oktal (CAS 637-12-7)) dhe ngurtësuesit M1, M2 e M3;

7. Perkloratet, kloratet dhe kromatet me metal pluhur ose komponentë të tjera të lëndës djegëse të energjisë së lartë;

8. Pluhur aluminini sferik (CAS 7429-90-5) me madhësi grimcash deri 60 µm, prodhuar nga material që përmban deri 99% alumin;

9. subhidrid titani (TiH_n) i ekuivalentit stehimetric n = 0,65-1,68;

d. Oksiduesit dhe përzierjet e tyre si vijon:

1. ADN (dinitramid amoni ose SR 12) (CAS 140456-78-6);

2. AP (perklorat amoni) (CAS 7790-98-9);

3. Përzierje të formuara nga fluori dhe një nga përbërësit vijues:

a. Halogjenët e tjerë;

b. Oksigjeni; ose

c. Azoti;

Shënim 1: ML8.d.3. nuk lidhet me trifluoridin e klorit (CAS 7790-91-2).

Shënim 2: ML8.d.3. nuk lidhet me nitrogjen triflorid (CAS 7783-54-2) në gjendje të gaztë.

4. DNAD (1,3-dinitro-1,3-diazetidini) (CAS 78246-06-7);

5. HAN (nitrat hidroksilamon) (CAS 13465-08-2);

6. HAP (perklorat hidroksilamoni) (CAS 15588-62-2);

7. HNF (nitroformat hidrazine) (CAS 20773-28-8);

8. nitrat hidrazine (CAS 37836-27-4);

9. perklorat hidrazine (CAS 27978-54-7);

10. Oksidues të lëngët të përbërë ose që përmbajnë gaze frenuese të acidit nitrik (IRFNA) (CAS 8007–

58-7);

Shënim: ML8.d.10. nuk është i zbatueshëm për acid nitrik jo të ndezshëm;

e. Lidhësit, plastifikatorët, monomeret, polimeret, si vijon:

1. AMMO (azidometilmetiloksetan dhe polimeret e tij) (CAS 90683-29-7) (për "prekursorët" e tij shih edhe ML8.g.1.);
2. BAMO (bisazidometiloksetan dhe polimeret e tij) (CAS 17607-20-4) (për "prekursorët" e tij shih edhe ML8.g.1.);
3. BDNPA (bis (2,2-dinitropropil)acetal) (CAS 5108-69-0);
4. BDNPF (bis (2,2-dinitropropil)formal) (CAS 5917-61-3);
5. BTTN (butanetrioltrinitrat) (CAS 6659-60-5) (për "prekursorët" e tij shih edhe ML8.g.8.);
6. Monomeret energjetike, plastifikatorët ose polimeret formuluar posaçërisht për përdorim ushtarak, të cilët përmbajnë cilëndo nga sa vijon:
 - a. Grupet nitrik;
 - b. Grupet azido;
 - c. Grupet nitrate;
 - d. Grupet nitraze; ose
 - e. Grupet difluoroamine;
7. FAMA0 (3-difluoroaminometil-3-azidometil oksetan) dhe polimeret e tij;
8. FEFO (bis-(2-fluoro-2,2-dinitroetil)formal) (CAS 17003-79-1);
9. FPF-1 (poli-2,2,3,3,4,4-heksafluoropentan-1,5-diol formal) (CAS 376-90-9);
10. FPF-3 (poli-2,4,4,5,5,6,6-heptafluoro-2-tri-fluorometil-3-oksaheptan-1,7-diol formal);
11. GAP (polimer glicidilazidi) (CAS 143178-24-9) dhe derivatet e tij;
12. HTPB (polibutadien hidroksili) me funksionalitetin më të vogël të hidroksilit prej 2,2 dhe më të vogël ose të barabartë me 2,4, të vlerës hidroksile më të vogël se 0,77 meq/g dhe viskoziteti në 30 °C më i vogël se 47 puaz (CAS 69102-90-5);
13. poli(epiklorohidrinë) me grupe alkoolike funksionale me masa molekulare më të vogla se 10000, dhe konkretisht:
 - a. poli(epiklorohidrinëdiol);
 - b. poli(epiklorohidrinëdiol);
14. NENA (lidhjet nitratoetilnitramin) (CAS 17096-47-8, 85068-73-1, 82486-83-7, 82486-82-6 i 85954-06-9);

15. PGN (Poli-GLYN, poliglicidilinitrat ose poli(nitratometiloksiran) (CAS 27814-48-8);
 16. poli-NIMMO (poli nitratometilmetiloksetan) ose poli-NMMO (poli[3-nitratometil-3-metiloksetan]) (CAS 84051-81-0);
 17. polinitroortokarbonatet;
 18. TVOPA (1,2,3-tris[1,2-bis(difluoroamino)etoksi] propan ose tris vinoksi propan adut) (CAS 53159-39-0);
- f. ,aditivët' si vijon:
1. salicilati bazik i bakrit (CAS 62320-94-9);
 2. BHEGA (bis-(2-hidroksietil) glikolamidë) (CAS 17409-41-5);
 3. BNO (butadienenitrileoksid);
 4. Derivatet e ferrocenit, si vijon:
 - a. butacen (CAS 125856-62-4);
 - b. katocen (2,2-bis-etilferrocenil propan) (CAS 37206-42-1);
 - c. acid karboksil i ferrocen duke përfshirë:
acid karboksil i ferrocen (CAS 1271-42-7),
1,1'-ferrocen të acidit karboksil (CAS 1293-87-4);
 - d. n-butyl-ferrocen (CAS 31904-29-7);
 - e. Derivate të tjera të ngjashme të polimerit të aduktuar të ferrocenit;
 5. beta-resorcilat plumbi (CAS 20936-32-7);
 6. Citrat plumbi (CAS 14450-60-3);
 7. Kelate plumb-bakër të beta-resorcilatit ose të salicilatit (CAS 68411-07-4);
 8. Maleat plumbi (CAS 19136-34-6);
 9. Salicilat plumbi (CAS 15748-73-9);
 10. Stanat plumbi (CAS 12036-31-6);
 11. MAPO (tris-1-(2-metil)aziridinil fosfin oksid) (CAS 57-39-6); BOBBA 8 (bis(2-metil aziridinil) 2-(2-hidroksipropanoksi) propilamino fosfin oksid); dhe derivate të tjera MAPO;
 12. metil BAPO (bis(2-metil aziridinil) metilamino fosfin oksid) (CAS 85068-72-0);
 13. N-metil-p-nitroanilin (CAS 100-15-2);
 14. 3-nitrazo-1,5-pentan diisocianat (CAS 7406-61-9);

15. Agjentët e lidhjeve organo-metal, si vijon:

a. neopentil[diallil]oksi, tri[dioktil]fosfato-titanat (CAS 103850-22-2); gjithashtu i njohur si titan IV, 2,2[bis 2-propenolato-metil, butanolato, tris (dioktil) fosfato] (CAS 110438-25-0); ose LICA 12 (CAS 103850-22-2);

b. titan IV, [(2-propenolato-1) metil, n-propanolatometil] butanolato-1, tris[dioktil] pirofosfat dhe KR3538;

c. titan IV, [(2-propenolato-1) metil, n-propanolatometil] butanolato-1, tris(dioktil)fosfat;

16. policijanodifluoroaminoetilenoksid;

17. Amidë aziridine polifunkionale me struktura përforcuese izoftalike, trimesike (BITA ose butilen imin trimesamide), izocianurike ose trimetiladipike dhe zëvendësues 2-metil ose 2-etil në unazën e aziridine;

18. propileniminë (2-metilaziridin) (CAS 75-55-8);

19. Oksid hekuri super fin (Fe_2O_3) (CAS 1317-60-8) sipërfaqe specifike mbi 250 m²/g dhe madhësi mesatare të grimcës deri 3,0 nm;

20. TEPAN (tetraetilenpentaamineakrilonitril) (CAS 68412-45-3); cijanoetilzirani poliaminet dhe kripërat e tyre;

21. TEPANOL (tetraetilenpentaamineakrilonitrileglicidol) (CAS 68412-46-4); poliaminet e cijanoetilizuar të ngashëm me glicidolin dhe kripërat e tyre;

22. TPB (trifenil bizmut) (CAS 603-33-8);

g. ,prekursorët', si vijon:

Shënime të rëndësishme: Në ML8.g. referencat lidhen me "material energjetik" të cilat i nënshtrohen kontrollit, të cilat prodhohen nga këto substanca.

1. BCMO (bisklorometiloksetan) (CAS 142173-26-0) (shih edhe ML8.e.1. dhe e.2.);

2. dinitroazetidin-t-butil sol (CAS 125735-38-8) (shih gjithashtu ML8.a.28.);

3. HBIW (heksabenzilheksaazaizovurcitan) (CAS 124782-15-6) (shih edhe ML8.a.4.);

4. TAIW (tetraacetildibenzilheksaazaizovurcitan) (shih dhe ML8.a.4.); (CAS 182763-60-6);

5. TAT (1,3,5,7 tetraacetil-1,3,5,7-tetraaza ciklo-oktan) (CAS 41378-98-7) (shih dhe ML8.a.13.);

6. 1,4,5,8-tetraazadekalin (CAS 5409-42-7) (shih dhe ML8.a.27.);

7. 1,3,5-triklorobenzen (CAS 108-70-3) (shih dhe ML8.a.23.);

8. 1,2,4-trihidroksibutan (1,2,4-butanetriol) (CAS 3068-00-6) (shih ML8.e.5.).

Shënim 1: ML8 ka të bëjë me substancat e mëposhtme, nëse ato nuk janë të lidhura ose të përziera me "materiale energjetike" të përmendura në ML8.a. ose metale pluhur sipas ML8.c.:

- a. *Pikrat amoni (CAS 131-74-8);*
- b. *Pluhur i zi;*
- c. *heksanitrodifenilamin (CAS 131-73-7);*
- d. *difluoroamin (CAS 10405-27-3);*
- e. *Nitrogjen niseshte (CAS 9056-38-6);*
- f. *Nitrat kaliumi (CAS 7757-79-1);*
- g. *tetranitronaftalen;*
- h. *trinitroanisol;*
- i. *trinitronaftalen;*
- j. *trinitroksilen;*
- k. *N-pirolidinon; 1-metil-2-pirolidinon (CAS 872-50-4);*
- l. *dioktilmaleat (CAS 142-16-5);*
- m. *etilheksilakrilat (CAS 103-11-7);*
- n. *trietilalumini (TEA)(CAS 97-93-8), trimetilalumini (TMA) (CAS 75-24-1) dhe metale alkile të tjera piroforike dhe arile të litiumit, natriumit, magnezit, zinkut ose borit;*
- o. *nitroceluloza (CAS 9004-70-0);*
- p. *nitroglicerinë (ose gliceroltrinitrat, trinitroglicerinë) (NG) (CAS 55-63-0);*
- q. *2,4,6-trinitrotoluen (TNT) (CAS 118-96-7);*
- r. *etilendiamindinitrat (EDDN) (CAS 20829-66-7);*
- s. *pentaeritritoltetranitrat (PETN) (CAS 78-11-5);*
- t. *Acid plumbi (CAS 13424-46-9), stifnat plumbi normal, (CAS 15245-44-0) dhe stifnat plumbi bazik (CAS 12403-82-6) dhe eksplozivë inicialë ose përzierje iniziale të cilat përmbajnë acide ose lidhje acide;*
- u. *trietileneglicoldinitrat (TEGDN) (CAS 111-22-8);*
- v. *2,4,6-trinitroresorcinol (acid stifnik) (CAS 82-71-3);*
- w. *Ure dietildifenil (CAS 85-98-3); ure dimetildifenil (CAS 611-92-7); ure metiletildifenil [centralit];*
- x. *N,N-difenilure (difenilure asimetrike) (CAS 603-54-3);*
- y. *netil-N,N-difenilurea (difelinure nesimetrike metili) (CAS 13114-72-2);*
- z. *etil-N,N-difenilurea (metildipfenilure asimetrike) (CAS 64544-71-4);*

aa. 2-nitrodifenilamin (2-NDPA) (CAS 119-75-5);

bb. 4-nitrodifenilamin (4-NDPA) (CAS 836-30-6);

cc. 2,2-dinitropropanol (CAS 918-52-5);

dd. nitroguanidin (CAS 556-88-7) (shih 1C011.d. në Listën e mallrave për qëllim të dyfishtë të BE-së).

Shënim 2: ML8 nuk përfshin perkloratin e amonit (ML8.d.2.) dhe NTO (ML8a.18.) të trajtuar dhe përgatitur për pajisjet që formojnë gazin për përdorim civil:

a. Të cilët janë lidhur ose përzier me lidhjet ose plastifikatorët joaktive duromere;

b. deri 80 % të masës së materialit aktiv është perklorat amoni(ML8.d.2.);

c. përmbajnë deri 4 g NTO-së (ML8.a.18.); i

d. Masa individuale e tyre është nën 250 g.

ML9 Llundruet luftimi (sipërfaqësore ose nënujore), pajisje speciale marine, aksesorë, komponentë ose lundruet të tjerë sipërfaqësorë, si vijon:

Shënime të rëndësishme: Për pajisjen për kërkim de navigim, shih ML11.

a. Anijet dhe komponentët e tyre:

1. Anijet (sipërfaqësore ose nën ujore) të projektuara ose modifikuara për përdorim ushtarak, pavarësisht gjendjes aktuale, pavarësisht nëse kanë në përbërje sisteme armësh dhe kabina të blinduara apo pjesë për trup anijeje dhe varka të projektuara për përdorim ushtarak;

2. Anijet sipërfaqësore, përveç atyre të përcaktuara në ML9.a.1, që kanë ndonjë nga pajisjet e mëposhtme të montuar ose të integruar në anije:

a. Armë automatike e paraqitur në ML1, të kalibrit mbi 12,7 mm ose armë të paraqitura në ML2, ML4, ML12 ose ML19 ose "aksesorët" ose pika të forta të këtyre armëve;

Shënime teknike

"Aksesorët" lidhen me montimet mbi armë ose përforcimet strukturore për vendosjen e armatimit.

b. Sistemet për menaxhimin e shkrepjes janë paraqitur në ML5;

c. Të cilat kanë:

1. Mbrojtjen "kimike, biologjike, radiologjike ose nukleare" (KBRN); dhe

2. "sistemi i larjes ose shpëlarjes "për dekontaminim; ose

Shënime teknike

1. "Mbrojtja KBRN" është ambient i brendshëm i pavarur për karakteristikat siç janë sigurimi i mbitensionit, izolimi i sistemit ventilues, hapjet për ventilimin e organizuar me filtra KBRN dhe numër të kufizuar pikash për hyrjen e personelit që përfshin dhomat e ajrit.

2. "sistemi i larjes ose shpëlarjes" është sistem i spërkatjes i ujit të detit, i cili njëkohësisht shpëlan pjesën e jashtme të strukturës dhe kuvertën e anijes

d. Sistemet e armatosur për mbrojtjen kimike të paraqitur në ML4.b., ose ML5.c. ose ML11.a. dhe kanë:

1. "mbrojtjen KBRN"
2. Trupi i lundruesit dhe superstrukturës, të projektuar posaçërisht për uljen e reflektimit radar;
3. Pajisjet për uljen e të shprehurit termal (p.sh. sistemi për ftohjen e gazrave shkarkues), përveç mjeteve të projektuar posaçërisht për rritjen e efektivitetit të përgjithshëm të centralit ose zvogëlimin e ndikimit ndaj ambientit; ose
4. Sistemi i projektuar për zvogëlimin e ndërfaqes magnetike tek të gjithë lundruesit;

b. Motorët ose sistemet motorik, prodhuar posaçërisht për qëllim ushtarake dhe komponentët e tyre të prodhuar posaçërisht për qëllime ushtarake, si vijon:

1. Motorët dizel të projektuar posaçërisht për nëndetëset të cilat kanë:

- a. Fuqi dalëse mbi 1,12 MW (1500 KS); dhe
- b. Shpejtësi rotulluese mbi 700 rpm/min;

2. Motorët elektrik të projektuar posaçërisht për nëndetëset, të cilët:

- a. Kanë fuqi dalëse mbi 0,75 MW (1 000 KS)
- b. Kanë aftësinë e ndryshimit të shpejtë të drejtimit në lëvizjen prapa;
- c. Kanë ftohje me ujë;
- d. Janë plotësisht të mbyllur;

3. Motorët dizel jomagnetik të cilët kanë:

- a. Fuqi dalëse mbi 37,3 K Ë (50 KS); dhe
- b. Pjesët magnetike mbi 75% të masës së përgjithshme;

4. "sistemet motorike të pavarur nga ajri" (AIP) prodhuar posaçërisht për nëndetëset;

Shënime teknike

"Sistemi motorik i pavarur nga ajri" (AIP) i mundëson nëndetëses që gjatë udhëtimit nënujor për periudha të gjata kohore të shërbejë nëpërmjet sistemit të tij motorik pa përdorim të oksigjenit atmosferik më gjatë se sa do të mundësonte vetë bateria. Për qëllimet e ML9.b.4. AIP nuk përfshin energjinë bërthamore.

c. Pajisjet nënujore për zbulim të projektuar posaçërisht përdorimit ushtarak, pajisje për menaxhimin e tyre dhe komponentët e tyre, të projektuar posaçërisht përdorimit ushtarak;

d. Rrjetat anti-nëndetëse dhe rrjetat anti-silur, të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak;

e. Nuk përdoret nga viti 2003;

f. Pajisjet për shpimin e trupave dhe lidhjet projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak të cilat mundësojnë ndërveprimin me pajisjen jashtë lundruesit dhe përbërësit e tyre, projektuar posaçërisht për nevoja ushtarake;

Shënim: ML9.f. përfshin bashkuesit për anijet, të llojit me një ose me shumë drejtues, koaksialë ose me orientim vale, dhe mjetet që futen në trupin e anijes, që të dyja të papërshkueshme nga uji dhe kanë karakteristikat e kërkuara për kërkime në thellësi mbi 100 m; dhe fibrat optike dhe mjetet optike që futen në trupin e anijes, të projektuara për transmetimin e rrezeve "laser" pavarësisht thellësisë. ML9f. nuk zbatohet për boshtet e zakonshme lëvizëse dhe as për drejtimin hidrodinamik të shufrave depërtuese të trupit të anijes; ML9.f. nuk zbatohet për boshtet e zakonshme lëvizëse dhe as për drejtimin hidrodinamik të shufrave depërtuese të trupit të anijes;

g. Kushinetat pa zhurmë, komponentët dhe pajisjet që përmbajnë këto lloj kushinetash, të projektuara për përdorim ushtarak, të cilat kanë karakteristikat e mëposhtme:

1. zbutje magnetike ose me gaz;
2. kontroll aktiv të zhurmave akustike; ose
3. reduktim të dridhjeve.

ML10 "Avionët", "mjetet fluturuese më të lehta se ajri", mjetet fluturuese pa personel ("UAV"), motorët ajrorë dhe pajisjet e avionëve, si komponentët e lidhur me to të projektuara ose modifikuar për përdorim ushtarak:

Shënime të rëndësishme: Për pajisjen për kërkim de navigim, shih ML11.

a. "avionë" me ekuipazh dhe "avionë më të lehtë se ajri" dhe komponentët e prodhuar posaçërisht për to;

b. Nuk përdoret nga viti 2011;

c. Avionë pa ekuipazh dhe pajisjet përkatëse si dhe komponentët e prodhuar posaçërisht për to si vijon:

1. 'avionë pa pilot', avionë me pilotim në distancë (RPV), fluturues autonom të cilët mund të programohen dhe 'automjete më të lehtë se ajri' pa ekuipazh;
2. raketahedhësit, pajisje për riparim dhe pajisje për mbështetje tokësore;
3. Pajisje për komandim ose mbikëqyrje;

d. motorët për avionë dhe komponentët e prodhuar posaçërisht për to;

e. Pajisjet e avionëve për furnizim me karburant në fluturim dhe komponentët e përgatitur posaçërisht për to, të prodhuar posaçërisht ose të modifikuar për:

1. "avionët" e paraqitur në ML10.c.; ose
2. avionët pa ekuipazh të paraqitur në ML10.c.;

f. 'pajisje tokësore' prodhuar posaçërisht për avionët e paraqitur në ML10.a. ose motorët për avionë

të paraqitur në ML10.d.;

Shënime teknike:

"pajisjet tokësore" përfshijnë pajisjet për mbushjen me karburant nën presion dhe pajisjen e prodhuar posaçërisht për punë me ambient të kufizuar.

g. Pajisjet për mbijetesë të ekuipazhit, pajisjet e sigurimit të ekuipazhit dhe pajisje të tjera për daljen në urgjencë, të cilët janë paraqitur në ML10.a.;

Shënim: ML10.g. nuk kontrollon helmetat për ekuipazhin të cilët nuk përfshijnë ose nuk kanë mbajtës ose aksesore për vendosjen e pajisjeve të paraqitura në listën e Përbashkët të mallit me qëllim të dyfishtë të BE-së.

Shënime të rëndësishme: Për helmetat shih edhe ML13.c.

h. Parashutat, paraglajder-ët dhe pajisjet përkatëse si dhe komponentët të cilat janë prodhuar posaçërisht për to, si vijon:

1. Parashutat të cilat nuk janë paraqitur në listën e përbashkët të mallrave ushtarake të BE-së;
2. Paraglajder-ët;
3. Pajisjet e projektuar posaçërisht për parashutat në lartësi të mëdha (p.sh. pjesët, kasketat speciale, sistemet për frymëmarrje, pajisjet për navigacion);

i. Pajisjet për hapje të kontrolluar ose sisteme të pilotimit automatik të projektuar për hedhje të ngarkesës me parashutë.

Shënim 1: ML10.b. nuk zbatohet për "avionë", "automjete më të lehta se ajri", ose variante "avioni" të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak dhe:

- a. Të cilët nuk janë avionë luftarakë;
- b. Të cilët nuk janë konfiguruar për përdorim ushtarak dhe as janë pajisur me aksesore ose shtesa të cilat janë prodhuar posaçërisht ose modifikuar për përdorim ushtarak; dhe
- c. Organi kompetent i të cilave për aviacionin civil në shtetin anëtar të BE-së ose në shtetin që bën pjesë në marrëveshjen e Wassenaar për përdorim civil.

Shënim 2: ML10.d. nuk lidhet me:

- a. motorët e mjeteve fluturuese të projektuara ose modifikuara për përdorim ushtarak, të cilat janë certifikuar nga autoritetet e aviacionit civil në shtetin anëtar të Bashkimit Evropian ose shtetit anëtar pjesëmarrës në Marrëveshjen e Wassenaar-it për përdorim në "avionët civilë", ose komponentët e projektuar posaçërisht për to;
- b. motorët me piston ose komponentët e projektuar posaçërisht për to përveç atyre të projektuar për "avionë pa pilot".

Shënim 3: ML10.a. dhe ML10.d. për komponentë të projektuar posaçërisht dhe pajisjet përkatëse për "avionët" joushtarak ose motorët për avionë të modifikuar për përdorim ushtarak zbatohet vetëm për ato komponentë ushtarakë dhe pajisje ushtarake respektive të cilat është e nevojshme të modifikohen për përdorim ushtarak.

Shënim 4: Për qëllimet e ML10.a. pajisjet ushtarake përfshijnë: luftën, zbulimin ushtarak, sulmin, stërvitjen ushtarake, mbështetjen logjistike dhe mekanikën e transportit dhe të parashutimit ose pajisjet ushtarake.

Shënim 5: ML10.a. nuk lidhet me "avionë" që:

a. janë prodhuar para vitit 1946;

b. Nuk përfshijnë objektet e paraqitur në listën e përbashkët të mallrave ushtarake të BE-së, përveç kur këto objekte janë të nevojshëm për plotësimin e standardeve të sigurisë dhe lundrimit të shtetit anëtar të BE-së ose të shtetit i cili është pjesë e marrëveshjes Wassenaar; dhe

c. Nuk përfshijnë armatimin e paraqitur në listën e përbashkët të mallrave ushtarake të BE-së, vetëm në qoftë se ky armatim është i papërdorshëm ose funksionet e tij nuk mund të kthehen më për të.

ML11 Pajisje elektronike, "anijet kozmike" dhe komponentët që nuk janë paraqitur në listën e përbashkët të mallrave ushtarake të BE-së, si vijon:

a. pajisjet elektronike të prodhuara posaçërisht për përdorim ushtarak dhe komponentët e prodhuar posaçërisht për to;

Shënim: ML11.a. përfshin:

a. Pajisjet kundërvepruese dhe pajisjet elektronike kundër -kundërvepruese (p.sh pajisjet e projektuara për të lëshuar sinjale të huaja ose të gabuara në radar ose në pajisjet e lidhjes me radio ose që të pengojnë marrjen, punën ose efektivitetin e pajisjeve marrëse të kundërshtarit), ku përfshihen dhe pajisjet e tyre kundër-kundërvepruese

b. Llambat e frekuencave të shpejta;

c. Sistemet elektronike ose pajisjet e projektuara për vëzhgimin dhe kontrollin e spektrit elektromagnetik për informim ushtarak ose qëllime sigurie ose masa sigurie ose për masa kundër këtij vëzhgimi dhe kontrolli;

d. Kundërveprimet nën ujë, ku përfshihen zhurmimi dhe prishja e sinjalit akustik, pajisjet e projektuara për të lëshuar sinjale të huaja ose të gabuara në pajisjen marrëse të hidrolokatorit;

e. Pajisjet e përpunimit të të dhënave të sigurisë, pajisjet e të dhënave të sigurisë dhe të transmetimit dhe sinjalizimit që përdorin proceset e kodimit;

f. Pajisjet për identifikimin, konfirmimin e identitetit dhe hedhjen e shifrës dhe pajisjet për prodhimin dhe shpërndarjen e shifrës dhe menaxhimit të tyre;

g. Pajisjet për kërkim dhe navigim;

h. Pajisjet radio dixhitale për transmetimin e informacioneve;

i. Demodulatorët dixhital prodhuar posaçërisht për kontrollin e sinjalit;

j. "sisteme të automatizuar për komandim dhe kontroll".

Shënime të rëndësishme: Për "softuerët" e lidhur me radiot e përcaktuara nga "softueri"(SDR), shih ML21.

b. Pajisjet për pengimin e sistemeve satelitorë navigues global (GNSS) dhe komponentët e prodhuar posaçërisht për to;

c. 'anijet kozmike' prodhuar posaçërisht ose modifikuar për përdorim ushtarak dhe komponentët për "anije kozmike" prodhuar posaçërisht për përdorim ushtarak.

ML12 Sistemet e armatimit me energji kinetike të madhe dhe pajisjet përkatëse vijuese si dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to:

a. Sistemet e armatimit të cilët përdorin energjinë kinetike projektuar posaçërisht për asgjësimin e objektivit ose kryerjen e ndërprerjes së veprimit sipas objektivit;

b. Pajisje e prodhuar posaçërisht për testim dhe vlerësim të modeleve testues, përfshirë instrumentet diagnostikues dhe objektivët për testim dinamik të predhave dhe sistemeve kinetike.

Shënime të rëndësishme: Për sistemet e armatimit që përdorin municion të nënkalibruar ose vetëm veprim kimik dhe predha përkatëse shih ML1 deri ML4.

Shënim 1: ML12 përfshin si vijon, në qoftë se është i projektuar posaçërisht për sistemet e armatosura që përdorin energjinë kinetike:

a. Të sistemeve të raketahedhësve që janë të aftë për përshpejtim të masave mbi 0,1 g deri në shpejtësitë mbi 1,6 km/s, në formën e shkrepjes individuale ose të shpejtë;

b. Për krijimin e forcës primare, mbështjellë elektrike, ruajtje të energjisë, menaxhim të nxehtësisë, ftohje, pajisje për futjen dhe përdorimin e lëndës djegëse; dhe lidhjet elektrike ndërmjet përcjellësve të rrymës, dhe funksioneve të tjera të lëvizjes elektrike të kupolës;

c. Sistemet për përcaktimin e pozicionit dhe ndjekjen e objektivit, për kontrollin e zjarrit dhe për vlerësimin e dëmit;

d. Sistemet e kërkimit të objektivit, sistemet orientuese ose shmangëse të shtyrjes (shpejtësia laterale) për raketat.

Shënim 2: ML12 kontrollon sistemet e armatimit të cilat përdorin cilëndo nga metodat lëvizëse të paraqitura më poshtë:

a. Elektromagnetike;

b. Elektrotermike;

c. Plazms;

d. Gaz i lehtë; ose

e. Kimike (kur përdoret në kombinim me cilëndo metodë të paraqitur).

ML13 Pajisjet blinduese ose mbrojtëse dhe konstruktet dhe komponentët, si vijon:

a. Pllakat e blinduara të cilat:

1. Janë prodhuar në bazë të standardeve ushtarake ose specifikimeve; ose

2. Janë të përshtatshme për përdorim ushtarak;

Shënime të rëndësishme: Për pllaka për jelekët (kostumet) mbrojtës shih ML13.d.2.

b. Konstruktet prej materiali metalik ose jometalik dhe kombinimet e tyre të projektuara posaçërisht ofrojnë mbrojtje balistike të sistemeve ushtarake dhe për komponentët e prodhuara posaçërisht për to;

c. Kasketa të prodhuara në bazë të standardeve ose specifikimeve ushtarake ose të standardeve përkatëse kombëtare dhe të komponenteve të projektuara posaçërisht për to; (p.sh. kasketat, jelekët për zbutjen e goditjes);

d. jelekët mbrojtës ose kostumet mbrojtëse dhe komponentët e tyre, si vijon:

1. jelekët e butë mbrojtës dhe veshjet mbrojtëse prodhuar në përputhje me standardet dhe specifikimet ushtarake, ose në përputhje me normat ekuivalente, dhe komponentët e projektuara posaçërisht për to;

Shënim: Për qëllimet e ML13.d.1. standardet ose specifikimet ushtarake përfshijnë të paktën specifikimet për mbrojtjen nga copat e thyera;

2. Pllakat e forta për jelekët mbrojtës të cilët mundësojnë mbrojtje balistike të nivelit III ose më të lartë (NIJ 0101.06 Korrik 2008) ose në bazë të normave ekuivalente kombëtare.

Shënim 1: ML13.b. përfshin materialet e projektuara posaçërisht për të siguruar mbrojtje nga armët e shpërthimit reaktiv ose për ndërtimin e strehimeve ushtarake.

Shënim 2: ML13.c. nuk lidhet me kasketat konvencionale prej çeliku pavarësisht nëse ato janë të modifikuar ose prodhuar për pranimin ose pajisjen e çdo lloji pajisje shtesë.

Shënim 3: ML13.c. dhe d. nuk lidhet me kasketat, gjerdanët mbrojtës ose veshjet mbrojtëse kur klienti i mban ato me vete për mbrojtjen e tij personale.

Shënim 4: Nga kasketat e prodhuar posaçërisht për personat që merren me deaktivizimin e pajisjeve shpërthyesë ML13 kontrollon vetëm ato të cilat janë projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak.

Shënim i rëndësishëm 1: Shih edhe 1A005 në Listën e mallit të BE-së me qëllim të dyfishtë.

Shënim i rëndësishëm 2: Për "materialet fibroze ose prej filamenti" të cilët përdoren në prodhimin e mbrojtjes së trupit dhe kasketës, shih 1C010 në listën e mallrave me qëllim të dyfishtë të BE-së.

ML14 "pajisje të specializuara për stërvitje ushtarake" ose simulimin e skenarëve ushtarakë, të projektuar posaçërisht stërvitjes me përdorim të çfarëdo lloji arme zjarri ose armatimi të cilin e kontrollon ML1 ose ML2 dhe komponentët e aksesorët e projektuar posaçërisht për këtë.

Shënime teknike:

Termi "pajisje të specializuara për stërvitje ushtarake" përfshin llojet e simulatorëve të sulmit, simulatorëve operacionalë të fluturimit, simulatorët e radarëve të objektivave, gjeneratorët e gjetjes së objekteve, pajisjet e stërvitjes me top, simulatorët e stërvitjes për luftën kundër nëndetëseve, simulatorët e fluturimit (ku përfshihen dhe centrifugat për njerëzit për stërvitjen e pilotëve dhe astronautëve), pajisjet e stërvitjes për radarët, simulatorët e fluturimit me instrumente, simulatorët e orientimit, simulatorët e lëshimit të raketave, pajisjet e gjetjes së objektivit, avionëve pa personel, simulatorët e armatimit, simulatorët e "avionëve" pa ekuipazh, njësitë e stërvitjes së lëvizshme dhe pajisjet për operacionet tokësore.

Shënim 1: ML14 përfshin sistemet për gjenerimin e imazhit dhe ambienteve ndërvepruese për simulatorët, kur janë të projektuara ose të modifikuara për përdorim ushtarak.

Shënim 2: ML14 nuk zbatohet për pajisjet e projektuara posaçërisht për stërvitje dhe përdorimin e armëve të gjuetisë ose armëve sportive.

ML15 Pajisjet e imazhit ose të kundërveprimit dhe komponentët dhe aksesorët e tyre në vijim, të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak:

- a. Pajisjet për regjistrim dhe përshtatje figure;
- b. Kamerat, pajisjet për fotografim dhe përshtatje filmash;
- c. Pajisjet për figurë të përforcuar;
- d. Pajisjet për paraqitjen e pamjeve infra të kuqe ose termike;
- e. Pajisjet me ndjeshmëri radari për paraqitjen e figurës;
- f. Pajisjet për kundërmatje ose kundër-kundërmatje, projektuar pajisjeve paraqitur në ML15.a. deri ML15.e.

Shënim: ML15.f. përfshin pajisjen e projektuar për bllokimin e punës ose të efektit të sistemeve ushtarake për paraqitjen e figurave ose minimizimin e aftësisë së tyre.

Shënim 1: Në ML15, termi "komponentë të projektuara posaçërisht" përfshin, komponentët e mëposhtëm kur janë të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak:

- a. Llambat e konvertimit të imazhit infra të kuq;
- b. Kinoscope/llambat e intensifikimit të imazhit (përveç gjeneratës së parë);
- c. Pllakat me mikrokanale;
- d. Llambat e kamerave televizive me nivel të ulët ndriçimi;
- e. pajisjet detektore (përfshirë ndërlidhjen elektronike ose sistemet e leximit);
- f. Llambat piroelektrike të kamerave televizive
- g. Sistemet ftohëse për sistemet e imazhit;
- h. Diafragmat me mbyllje elektrike të tipit fotokromik ose të tipit elektro-optik që kanë një shpejtësi të diafragmës më të vogël se 100 μ s, përveçse në rastet të cilat janë pjesë bazë e një aparati fotografik për shpejtësi të larta;
- i. Inverterat e imazhit me fibër optike;
- j. Fotokatodat e përbëra gjysmëpërcjellëse

Shënim 2: ML15 lidhet me "llamba përforcuese të imazhit të gjeneratës së parë" ose pajisje e cila është projektuar posaçërisht instalimit në "llambat përforcuese të imazhit të gjeneratës së parë".

Shënime të rëndësishme: Për klasifikimin e objektivit për armën pjesë përbërëse e të cilit është "llamba përforcuese e imazhit e gjeneratës së parë" shih ML1, ML2 dhe ML5.a.

Shënime të rëndësishme: Shih edhe 6A002.a.2. dhe 6A002.b. në Listën e mallit të BE-së me qëllim të

dyfishtë.

ML16 Produktet e farkëtuara, të derdhura dhe produkte të tjera të papërfunduara, të projektuara posaçërisht për artikujt e specifikuar në ML1 deri në ML4, ML6, ML9, ML10, ML12 ose ML19.

Shënim: ML16 zbatohet për produktet e papërfunduara, kur ato janë të identifikueshme nga përbërja e materialit, gjeometria ose funksioni.

ML17 Pajisjet e shumëllojshme, materialet dhe "bibliotekat" si vijon dhe komponentët e projektuar posaçërisht për to:

a. Aksesorë të plotë për zhytje dhe notim nënujor si vijon:

1. Aksesor i këndit të mbyllur ose gjysmë të mbyllur (përsëritje frymëmarrje) projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak (d.m.th. të konstruktuar posaçërisht që të mos jetë magnetike);
2. Komponentë të prodhuar posaçërisht për përdorim gjatë përpunimit të aksesorit të këndit të mbyllur për përdorim ushtarak;
3. Objekte të projektuara ekskluzivisht për përdorim ushtarak me aksesorë të plotë për zhytje dhe notim nënujor;

b. Pajisje ndërtimi të projektuara për përdorim të posaçëm ushtarak;

c. Shtesat, veshjet dhe trajtimi për minimizimin e lakimit, projektuar për përdorim të posaçëm ushtarak;

d. Pajisje inxhinierike terreni të projektuara posaçërisht për përdorimin në fushë luftimi;

e. "Robotët", komanduesit e robotëve', "robotët" "ndikuesit fundorë" të cilët:

1. Janë të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak;
2. Përfshijnë mjetet për mbrojtjen e linjave hidraulike nga goditjet e shkaktuara nga fragmentet balistike (p.sh. duke përfshirë linjat vetëngjithëse) dhe përdorin lëngje hidraulike të pikës së ndezjes mbi 839 K (566°C); ose
3. Janë të projektuara plotësisht ose të vlerësuar për punë në ambientin e impulsit elektromagnetik.

Shënime teknike:

Impulsi elektromagnetik nuk lidhet me ndikimin reciprok të paqëllimshëm shkaktuar nga rrezatimi elektromagnetik i pajisjeve të afërta (p.sh. i mekanikës, mjeteve ose pajisjeve elektronike) ose për shkak të goditjes nga rrufeja.

f. "Bibliotekat" (teknika parametrike e bazës së të dhënave) të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak me pajisjen e cila i nënshtrohet kontrollit sipas listës së Përbashkët të mallit me qëllim të dyfishtë të BE-së;

g. Pajisjet bërthamore ose pajisjet shtytëse përfshirë "reaktorët bërthamorë" të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak dhe komponentët e tyre të prodhuar ose të modifikuar për përdorim ushtarak;

h. Pajisja dhe materiali, i mbuluar ose trajtuar për uljen e mundësive të zbulimit të pozicionit, projektuar posaçërisht përdorimit ushtarak, përveç atyre të cilët i nënshtrohen kontrollit sipas

paragrafëve të tjerë të listës së Përbashkët të mallit me qëllim të dyfishtë të BE-së;

- i. Simulatorët e prodhuar posaçërisht për "reaktorë bërthamorë" ushtarak;
- j. Ofiçinat e lëvizshme të riparimit të projektuara ose modifikuara për riparimin e mjeteve ushtarake;
- k. Gjeneratorët për në terren, të ndërtuar ose modifikuar për përdorim ushtarak;
- l. Kontejnerët e projektuar ose modifikuar për përdorim ushtarak;
- m. Tragetet, përveç atyre që kontrollohen sipas paragrafëve të tjerë të listës së përbashkët të mallrave ushtarake të BE-së, urave dhe mjetet lundruese, të projektuara posaçërisht për përdorim ushtarak;
- n. Modelet testuese të projektuara posaçërisht për "zhvillim" të mjeteve të cilat i nënshtrohen kontrollit sipas ML4, ML6, ML9 ose ML10;
- o. Pajisje për mbrojtjen nga laserët (p.sh. për mbrojtjen e syve ose sensorë) projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak;
- p. "Qelizat e karburantit" përveç atyre të cilat kontrollohen sipas paragrafëve të tjerë të listës së përbashkët të mallrave ushtarake të BE-së, prodhuar posaçërisht ose "modifikuar" për përdorim ushtarak.

Shënime teknike

1. *Për qëllimet e ML17, termi "bibliotekë" ((bazë të dhënash – me parametra teknike) do të thotë mënyrat e grumbullimit të informacionit teknik me natyrë ushtarake, referencë për të cilën mund të rrisë performancën e sistemeve ose pajisjeve ushtarake.*
2. *Për qëllimet e ML17 "modifikim" do të thotë ndryshim strukturor, elektrik, mekanik ose ndryshim tjetër që nëpërmjet pajisjes joushtarake jep karakteristika ushtarake ekuivalente me pajisjen tjetër që është prodhuar posaçërisht për përdorim ushtarak.*

ML18 Pajisjet për prodhimin e produkteve dhe komponentëve si vijon:

- a. 'Produkt' pajisje të prodhuara posaçërisht ose të modifikuara për "prodhim" të produkteve të paraqitura në listën e përbashkët të mallrave ushtarake të BE-së, si dhe komponentët e projektuara posaçërisht për to;
- b. Mjete të projektuara posaçërisht për testimin e ambientit dhe pajisje të projektuara posaçërisht për to, për dhënien e konfirmimit, paraqitjen dhe testimin e produkteve të paraqitura në listën e Përbashkët të BE-së.

Shënime teknike:

Për qëllimet e ML18, termi "prodhim" përfshin krijimin, provën, prodhimin, testimin dhe verifikimin.

Shënim: ML18.a. dhe ML18.b. përfshijnë pajisjet si më poshtë:

- a. *Pajisjen për nitrumin të vazhdueshëm;*
- b. *Aksesorë për testim centrifugal ose pajisje:*
 1. *Që nis motorin ose motorët e me fuqi të përgjithshme të vlerësuar në kuaj fuqi mbi 298 Kw (400 kf);*

2. *Që ka kapacitet mbartës të ngarkesës së dobishme mbi 113 kg; ose*
3. *Që ka mundësinë e shpejtësisë centrifugale mbi 8 g tek kapaciteti mbartës mbi 91 kg;*
- c. *Presat dehidratuese;*
- d. *Nxjerrësit e vidave të projektuar ose të modifikuar për nxjerrjen e eksplozivëve ushtarakë;*
- e. *Makineritë prerëse për lëndët shtytëse të dala;*
- f. *Mbështetëset (mbajtëset) me diametër 1,85 m ose më tepër dhe me kapacitet më të madh se 227 kg;*
- g. *Përzierësit e vazhdueshëm për mbushjet e barutit (përzierës të vazhduar për barutet);*
- h. *Mullinjtë fluid për bluarje dhe thërrmim të përbërësve të eksplozivëve ushtarakë;*
- i. *Pajisje për arritjen e sferizimit dhe uniformitetit të madhësisë së grimcës në miellrat metalik të paraqitur në ML8.c.8;*
- j. *Lëshuesit e rrymës konvekse për përpunimin e materialeve të paraqitur në ML8.c.3.*

ML19 Sistemet e armatimit të energjisë së drejtuar (DEW), pajisjet e lidhura me to ose mjetet për kundërmajtje dhe modelet e provës, si vijon, dhe komponentët e projektuar për to:

- a. *Sisteme "laser" të projektuar posaçërisht për asgjësimin ose kryerjen e ndërprerjes së veprimeve kundrejt objektivit;*
- b. *Sistemet e rrezeve të qelizave që mund të shkatërrohen ose të kryhet ndërprerje e veprimit kundrejt objektivit;*
- c. *Sistemet e radiofrekuencave (RF) të fuqisë së lartë të cilat mund të shkatërrojnë ose të kryejnë ndërprerje të detyrës kundrejt objektivit;*
- d. *Pajisje të projektuar posaçërisht për gjetjen dhe identifikimin ose mbrojtjes nga sistemet e paraqitura në ML19.a. deri ML19.c.;*
- e. *Modelet e testimit fizik për sistemet dhe pajisjet e komponentët e paraqitur në ML19;*
- f. *Sistemet "laser" të projektuar posaçërisht për të shkakuar qorrim të përhershëm në qoftë se shikimi nuk është i mbrojtur, d.m.th në qoftë se personi nuk mban syze mbrojtëse ose në qoftë se mban mjete për korrektimin e shikimit.*

Shënim 1: Sistemet e energjisë me energji të drejtuar janë paraqitur në ML19 përfshirë sistemet mundësitë e të cilave kapërcejnë zbatimin e kontrolluar të:

- a. *"laserit" të fuqisë së mjaftueshme që të kryejnë asgjësimin në mënyrë të ngjashme me qitjen konvencionale;*
- b. *Përshpejtuesit të grimcave të cilat lëshojnë rreze të përthyer ose neutrale grimcash me fuqi shkatërruese;*
- c. *Transmetuesit të rrezeve radiofrekuencë të fuqisë me impuls të lartë ose të forcës mesatare të lartë që prodhojnë fusha mjaft të fuqishme që të pengojë elektronikën ndaj objektit të largët.*

Shënim 2: ML19 përfshin si vijon në qoftë se është i projektuar posaçërisht për sistemet e armatimit me energji të orientuar:

- a. Krijimin e forcës primare, ruajtjen e energjisë, mbylljen, pajisja për kushtëzimin e fuqisë ose përdorimin e lëndës djegëse;*
- b. Sistemet për kapjen dhe monitorimin e objektivit;*
- c. Sistemet të cilët mund të vlerësojnë dëmtimin e objektivit, asgjësimin ose braktisjen e veprimit;*
- d. Pajisjet e manovrimit të tufave të rrezes së përhapjes ose shënimit të një pike;*
- e. Pajisjet me lëvizje të shpejtë të tufës së rrezeve për veprimet e shpejta e të shumëfishta me objektivin;*
- f. Optikën e përshtatshme dhe bashkues faze;*
- g. Injektorë të energjisë për rrezet jonike hidrogjenike negative;*
- h. Komponentët e përshpejtuar "të kualifikuar për përdorim në hapësirë";*
- i. Pajisjet për grumbullimin e rrezeve negative të jonit;*
- j. Pajisjet për kontrollin dhe devijimin e tufave të joneve me energji të lartë;*
- k. Mbrojtëset "e kualifikuara hapësinore" për neutralizimin e rrymave të izotopeve negative të hidrogjenit.*

ML20 Pajisja kriogenike dhe "superpërcjellëse" në vijim dhe komponentët e aksesorët e projektuar posaçërisht për të:

- a. Pajisjet e prodhuar posaçërisht ose të formuara për instalim në automjetet për përgatitje ushtarake tokësore, detare dhe ajrore ose kozmike, me mundësi pune në lëvizje dhe prodhim ose mbajtja në temperaturën poshtë 103 K (-170 °C);

Shënim: ML20.a. përfshin sistemet mobile që përmbajnë ose përdorin aksesorë ose komponentë prodhimi prej materialesh jometalike ose përcjellës joelektrik siç janë plastika ose materiale të ngopur me rrëshirë epoksi.

- b. Pajisje elektrike "superpërcjellëse" (makineritë rrotulluese dhe transformatorët) e prodhuar posaçërisht ose të projektuara për instalim në mjet motorik në forcat tokësore, detare dhe ajrore ose për nevoja kozmike, me mundësinë e punës gjatë lëvizjes.

Shënim: ML20.b. nuk lidhet me gjeneratorët homopolarne hibride me rrymë direkte që kanë armaturë metalike normale të një fushe e cila rrotullohet në fushën magnetike të prodhuar nga spiralet superpërcjellëse me kusht që këto spirale janë të vetmit komponentë superpërcjellës në gjenerator.

ML21 , "Softuerët" si vijon:

- a. "Softueri" i prodhuar posaçërisht ose i modifikuar për "zhvillim", "prodhim" ose "përdorim" të pajisjeve ose materialeve paraqitur në listën e përbashkët të mallrave ushtarake të BE-së;
- b. "softueri" i posaçëm, përveç atyre paraqitur në ML21.a., si vijon:

1. "softuer" i projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak dhe për modelimin, simulimin dhe vlerësimin e sistemeve ushtarake;
 2. "softuer" të projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak dhe për simulim të skenarëve të operacioneve ushtarake;
 3. "softuer" për përcaktimin e efektit të armës për luftë kimike, bërthamore, konvencionale ose biologjike;
 4. "softuer" i projektuar posaçërisht për përdorim ushtarak dhe projektuar për aplikacione komanduese, komunikuese, kontrolluese e raportuese (C3I) ose për aplikacione komanduese, komunikuese, kontrolluese, llogaritëse dhe raportuese (C4I);
- c. "softuer" i cili nuk kontrollohet sipas ML21.a. ose b., prodhuar posaçërisht ose i modifikuar për kualifikimin e pajisjeve të cilat nuk specifikohen në listën e përbashkët të mallrave ushtarake për kryerjen e funksioneve ushtarake të pajisjeve të cilat specifikohen në këtë listë;

ML22 , "Teknologjia", si vijon:

- a. "teknologjia", përveç atyre të specifikuara në ML22.b., të cilat janë të nevojshme për "zhvillim", "prodhim" ose "përdorim" të secilit nga të paraqiturit në listën e përbashkët të mallrave ushtarake ushtarak të BE-së;
- b. "teknologjia" si vijon:
 1. "teknologjia" "e nevojshme" për projektim, përfshirë edhe komponentët mbështjellës dhe përdorimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e objekteve prodhuese për paragrafët e paraqitur në listën e përbashkët të mallrave ushtarake të Bashkimit Evropian, madje edhe në qoftë se komponentët e objekteve prodhuese nuk janë paraqitur;
 2. "teknologjia" "e nevojshme" për "zhvillim" dhe "prodhim" të armatimit të lehtë edhe kur përdoret për prodhimin e riprodhimeve të armëve të lehta antike;
 3. "teknologjia" "e nevojshme" për "zhvillim" ose "përdorim" të agjentëve toksikologjik dhe pajisjet korresponduese ose komponentët e kontrolluar në ML7.a. deri ML7.g.;
 4. "teknologjia" "e nevojshme" për "zhvillim" ose "përdorim" të "biopolimereve" ose kulturave qelizore specifike të specifikuara në ML7.h;
 5. "teknologjia" "e nevojshme" ekskluzivisht për inkuorporimin e "biokatalizatorëve" të specifikuar në ML7.i.1 në mbajtësit ushtarakë ose materialet ushtarake.

Shënim 1: "Teknologjia" "e nevojshme" për "zhvillim" ose "përdorim" të çdo artikulli p ë specifikuar në listën e përbashkët të mallrave ushtarake të BE-së mbetet nën mbikëqyrje madje edhe në qoftë se zbatohet për paragrafët e pakontrolluar në kësaj liste.

Shënim 2: ML22 nuk zbatohet për:

- a. "teknologjinë" e cila është minimumi i nevojshëm për instalimin, përdorimin, mirëmbajtjen (verifikimin) dhe riparimin e artikujve të cilët nuk janë kontrolluar ose eksporti i të cilëve nuk është miratuar;
- b. "teknologjinë" e cila në "zotërim publik" "kërkim shkencor bazë" ose informacionet minimale të nevojshme për aplikimin për patentë;

c. "teknologjinë" për induksion magnetik, për lëvizje të vazhduar të pajisjeve të transportit civil.

PËRKUFIZIMET E TERMAVE TË PËRMENDURA NË LISTË

Në vijim paraqiten përkufizimet e termave të përmendura në listë, sipas rendit alfabetik.

Shënim 1: Përkufizimet përdoren në të gjithë listën. Referencat janë për qëllime konsultimi dhe nuk kanë ndikim zbatimit të përgjithshëm të termave në tërësinë e listës.

Shënim 2: Fjalët dhe termat që përmban kjo listë e përkufizimeve janë përkufizime vetëm kur janë në "thonjëza". Përkufizimet e termave në thonjëza dyshe paraqiten edhe në shënimet teknike. Në të gjitha rastet tjera, fjalët dhe termat kanë kuptimin e tyre të përgjithshëm (sipas fjalorit).

ML7 "Përshtatur për përdorim në luftë"

Çdo modifikim ose seleksionim (siç është ndryshimi i pastërtisë, kohëzgjatjes, virulencës, karakteristikave të shpërhapjes ose rezistenca ndaj rrezeve UV) i bërë për të rritur efektivitetin në neutralizimin e njerëzve ose të kafshëve, shkatërrimin e pajisjeve, kulturave ose mjedisit.

ML8 "Aditivë"

Substancat që përdoren në lëndët plasëse për përmirësimin e vetive të tyre.

ML8, 10, 14 "Avion"

Mjet me krahë fiks, rrotullues (helikopterë), rotor lëvizës ose krahë lëvizës të cilët lëvizin nëpërmjet ajrit.

ML11 "Sistem i automatizuar komandimi dhe kontrolli"

Sistemet elektronike me ndihmën e të cilëve futen, përpunohen dhe transmetohen informacione të qenësishme për veprimin efektiv të grupit, formacioneve të mëdha, formacioneve taktike, trupave, anijeve, njërive vartëse ose sistemeve të armatosura në dispozicion. Kjo arrihet me përdorimin e pajisjeve kompjuterike dhe pajisjeve të tjera të specializuara për mbështetjen e funksioneve të komandimit ushtarak ose menaxhimit të organizimit. Funksionet kryesore të sistemeve të automatizuara për komandimin dhe kontrollin janë: mbledhja, ruajtja dhe përpunim i të dhënave në mënyrë të automatizuar dhe me efikasitet; paraqitja e situatës dhe rrethanave që ndikojnë në përgatitjen dhe zhvillimin e operacioneve luftarake; përlllogaritja operative dhe taktike për shpërndarjen e resurseve ndërmjet formacioneve luftarake ose elementeve me origjinë luftarake ose formacionit luftarak në përputhje me misionin ose gjendjen e operacionit; përgatitja e të dhënave për vlerësimin e situatës dhe miratimin e vendimit në çdo moment gjatë operacionit ose luftimit; simulimi kompjuterik i operacionit.

ML22 "Kërkim shkencor bazë"

Kërkimet eksperimentale ose teorike të cilat kryesisht kryhen për fitimin e njohurive të reja rreth parimeve kryesore ose fakteve të konstatuara, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me një objektiv ose zbatim praktik të caktuar.

ML7, 22 "Biokatalizatorët"

Enzimët për reaksione specifike kimike ose biokimike ose lëndë të tjera biologjike që bëjnë pjesë në agjentët e luftës kimike dhe përshpejtojnë shpërbërjen e tyre.

Shënime teknike:

"Enzimata" nënkuptojnë "biokatalizatorët" për reaksione specifike kimike ose biokimike.

ML7, 22 "Biopolimere"

Makromolekulat biologjike si vijon:

- a. Enzimata për reaksione specifike kimike ose biologjike;
- b. Antitruapat, monoklonalë, poliklonalë ose antiidiotope;
- c. Receptorë të zhvilluar ose të përpunuar posaçërisht.

Shënime teknike

1. *"Antitruapa antiidiotope" janë antitruapat që lidhen me antigjene specifike të vendit të lidhjes së antitruapave të tjerë.*
2. *"Antitruapa monoklonalë" janë proteinat të cilat lidhen me një vend antigjen dhe të cilat prodhohen nga një kulturë (grup) qelizore.*
3. *"Antitruapa poliklonalë" janë përzierjet proteinash që lidhen me agjentë të caktuar, të cilat prodhohen nga një ose më shumë kultura (grup) qelizore.*
4. *"Receptorë" janë strukturat makromolekulare biologjike që janë në gjendje të lidhin ligandet, lidhja e të cilëve ndikon në funksionet fiziologjike.*

ML4, 10 "Avionë civilë"

"Avionët" e paraqitur sipas emrit në listën e certifikatave të publikuara mbi aftësinë për të fluturuar të lëshuara nga autoritetet civile, të cilët fluturojnë në rrugët tregtare vendase ose ndërkombëtare dhe janë projektuar për përdorim legjitim civil, privat ose biznesi.

ML21, 22 "Zhvillim"

Lidhet me të gjithë fazat që i paraprijnë prodhimit serial siç janë: projektimi, kërkimi për qëllime të projektimit, analizës dhe konceptit, montimi dhe testimi i prototipit, prodhimi i skemave pilot, të dhënat konstruktive, procedura e transformimit të prototipit në produkt, përcaktimi i konfigurimit, integrimi, skica.

ML17 "Ndikues fundorë"

Mbërthyeset, veglat aktive ose të gjitha mjetet që përforcohen me flanxhë në fund të dorës manipuluese "të robotit"

Shënime teknike:

"Njësi veglash aktive" janë pajisjet për zbatimin e fuqisë shtesë, të energjisë përshtatëse ose sensorë në përshtatës.

ML 8, "Materiale energjetike"

Lëndët ose përzierjet të cilat, gjatë reaksionit kimik, çlirojnë energjinë e nevojshme për qëllimin e synuar. "Lëndë plasëse" "artikuj piroteknikë" dhe "lëndë djegëse" janë nënkategoritë të materialeve energjetike.

ML8, 18 "Lëndë plasëse"

Lëndët e ngurta, të lëngëta dhe të gazta ose përzierjet nga të cilat kërkohet detonim, gjatë përdorimit të tyre si mbushje primare, startuese ose kryesore në kapakët e ngjyrosur me mbushje shkatërruese dhe mbushje të tjera.

ML7 "Vektorët e shprehjes"

Mbartësit (p.sh. plazmidet dhe viruset) që përdoren për futjen e materialit gjenetik në qelizën bujtëse.

ML13 "Materialet fibroze ose prej filamenti"

Përfshijnë:

- a. Filamentet e vazhduara;
- b. Fijet e vazhdueshme;
- c. Fjongot, tekstilet, shiritat, tapetet;
- d. Fibrat e prera, fibrat e përzgjedhura dhe mbuluesit e fibrave koherente;
- e. Fijet monokristaline ose polikristaline të çdo gjatësie;
- f. Tuli i poliamidit aromatik.

ML15 "Llamba përforcuese të ndriçimit të gjeneratës së parë"

Llamba të fokusuara elektrostatische që përdorin fibra optike hyrëse dhe dalje ose anoda me faqe xhami, fotokatoda multi-alkale (S-20 ose S-25), por jo anoda mikrokanale amplifikuese.

ML 17 "Qelizë karburanti"

Pajisja elektrokimike e cila, duke përdorur lëndë djegëse nga një burim i jashtëm, konverton drejtpërdrejtë energjinë kimike në energji elektrike DC.

ML22 "Në zotërim publik"

Nënkupton "teknologjitë" apo "programet kompjuterike" që janë në dispozicion për përdorim publik pa kufizime në shpërndarjen e tyre të mëtejshme.

Shënim: Kufizimet e të drejtës së autorit nuk e përjashtojnë "teknologjinë" ose "softuerët" nga të qenit "në zotërim publik."

ML9, 19 "Laser"

Grup komponentësh të cilët prodhojnë dritë ambienti dhe me koherencë kohore të përforcuar nga stimulimi i emetimit të rrezatimit.

ML10 "Mjetet e transportit më të lehta se ajri"

Balonat dhe avionët që përdorin ajër të nxehtë ose gaz më të lehtë se ajri, si heliumi apo hidrogjeni.

ML17 "Reaktorët bërthamorë"

Përfshin artikujt brenda ose të bashkëngjitura në pjesët e reaktorit, pajisjet që kontrollojnë nivelin e fuqisë në bërthamë, si dhe përbërësit që normalisht përmbajnë ose vijnë në kontakt të drejtpërdrejtë ose kontrollojnë ftohësin parësor të bërthamës së reaktorit.

ML8 "Prekursorë"

Kimikate të veçanta të cilat përdoren në prodhimin e lëndëve plasëse.

ML18, 21, 22 "Prodhim"

Nënkupton të gjitha fazat e prodhimit si: projektimin e produktit, prodhimin, integrimin, analizën, inspektimin, testimin dhe kontrollin e cilësisë.

ML8 "Mbushje shtytëse"

Substanca ose përzierje që reagojnë kimikisht për të prodhuar volume të mëdha të gazesh të nxehta, në masa të kontrolluara, për të kryer punë mekanike.

ML4, 8 "Piroteknike"

Përzierjet e lëndëve djegëse të ngurta ose të lëngëta dhe oksiduesit të cilët, kur ndizen, i nënshtrohen një reaksion kimik energjetik në një normë të kontrolluar për të prodhuar vonesa kohore specifike, ose sasi nxehtësie, tymi, dritë të dukshme ose rrezatimi me rreze infra të kuqe. Piroforidet janë një nëndarje e artikujve piroteknikë, të cilët nuk përmbajnë oksidues, por ndizen në mënyrë spontane pas kontaktit me ajrin. Lëndë piroforne janë nëngrupe të lëndëve piroteknike, të cilat nuk përmbajnë oksidantë, por ndizen në mënyrë spontane kur bien në kontakt me ajrin.

ML22 "Të nevojshme"

Zbatuar në "teknologji", lidhet vetëm me atë pjesë të "energjisë" që përgjigjet veçanërisht për krijimin ose tejkalimin e nivelit të kontrolluar të performancës, karakteristikave dhe funksioneve. Kjo "teknologji" "e nevojshme" mund të ndahet ndërmjet shumë produkteve.

ML7 "Agjentët për kontrollin e trazirave"

Substancat të cilat, në kushte të pritshme të përdorimit për qëllime të kontrollit të trazirave, shkaktojnë shpejt të njerëzit irritim ose efekte fizike që i bëjnë ata të paaftë, efekte të cilat zhduken brenda një kohe të shkurtër pas përfundimit të ekspozimit (një nëndarje e "agjentëve për kontrollin e trazirave" janë gazet lotsjellës). (Lotsjellësit hyjnë në kategorinë e agjentëve për kontrollin e trazirave).

ML17 "Robot"

Një mekanizëm manipulimi, i cili mund të veprojë në një rrugë të vazhdueshme ose pike pas pike, mund të përdorë sensorë dhe ka të gjitha karakteristikat e mëposhtme:

- a. Është multifunksional;
- b. Është i aftë për të pozicionuar ose orientuar materiale, pjesë, mjete ose pajisje të veçanta përmes lëvizjeve të ndryshueshme në një hapësirë tredimensionale;
- c. Përfshin tre ose më shumë pajisje shërbimi të mbyllura ose të hapura, të cilat mund të përfshijnë motorët;
- d. "Mund të programohet nga përdoruesi" me mjetet e metodave të mësimin dhe rikthimit ose përmes

mjeteve të një kompjuteri elektronik i cili mund të jetë një kontrollues logjik i programueshëm, pa ndërhyrje mekanike.

Shënim: Përkufizimi i mësipërm nuk përfshin pajisjet e mëposhtme:

1. *Mekanizmat manipulues të cilët mund të komandohen manualisht ose nga distanca;*
2. *Mekanizmat manipulues me rrëshqitës të fiksuar që janë pajisje lëvizëse të automatizuara, të cilët punojnë sipas lëvizjeve të programuara të përcaktuara mekanikisht. Programi kufizohet mekanikisht nga ndalesa të fiksuar por të rregullueshme, të tilla si kunjat ose dhëmbëzat. Sekuenca e lëvizjeve dhe përcaktimi i rrugëve dhe këndeve nuk mund të ndryshohen nga mjete mekanike, elektronike ose elektrike;*
3. *Mekanizmat e manipulimit të sekuecave të ndryshueshme të kontrolluara mekanikisht, të cilat janë pajisje lëvizëse të automatizuara që operojnë sipas lëvizjeve të programuara mekanike fikse. Programi është i kufizuar mekanikisht me ndihmën e kufizuesve fiksues të përshtatur, siç janë kunjat dhe dhëmbëzat. Sekuenca e lëvizjeve dhe zgjedhja e rrugës ose i këndeve është i ndryshueshëm brenda modelit fiks të programit. Ndryshimet ose modifikimet e modelit të programit (p.sh. ndryshimet e kapëseve ose ndërrimet e pajisjeve kompjuterike) në një ose më shumë akse të lëvizjes kryhen vetëm nëpërmjet veprimeve mekanike;*
4. *Mekanizmat e manipulimit të sekuecave të ndryshueshme me servo-pajisje, që veprojnë në bazë të lëvizjeve fikse të programuara mekanikisht. Programi është i ndryshueshëm por sekuenca ndjek vetëm sinjalin binar nga pajisjet mekanike fikse elektrike binare ose ndalesa të ndryshueshme; Programi mund të jetë i ndryshueshëm, por sekuenca vijon vetëm në bazë të sinjalit binar prej pajisjes binare elektrike të fiksuar mekanikisht ose me ndihmën e kufizuesit;*
5. *Vinçat e përcaktuar si sisteme manipuluese të koordinatave karteziane të prodhuara si pjesë integrale e një rreshtimi vertikal të depozitave të ruajtjes dhe të projektuar për të pasur akses në përmbajtjen e këtyre depozitave për t'i ruajtur apo për t'i korrigjuar.*

ML21 "Softuer"

Një përmbledhje e një ose disa "programeve" ose "mikroprogrameve" të fiksuar në çfarëdo medie shprehjeje.

ML 11 "Anije kozmike"

Satelitët dhe sondat hapësinore aktive dhe pasive.

ML19 "Kualifikuar për përdorim në hapësirë"

Produktet janë të projektuar, prodhuar dhe testuar për të përmbushur kërkesat e veçanta elektrike, mekanike apo mjedisore për përdorim në nisjen dhe dislokimin e satelitëve apo të sistemeve të avionëve të lartësisë së lartë që operojnë në lartësi 100 km ose më shumë.

Shënim: Përcaktimi që objekti i "kualifikuar për përdorim në hapësirë" nuk do të thotë që edhe objektet e tjera nga i njëjti cikël prodhues ose e njëjta seri modeli janë "të kualifikuar për përdorim në hapësirë" në qoftë se nuk janë testuar në mënyrë individuale.

ML 20 "Superpërcjellës"

I referohet materialeve (p.sh. metaleve, aliazeve ose përzierjeve) të cilat mund të humbasin të gjithë rezistencën elektrike (p.sh. ata që mund të arrijnë një përcjellshmëri elektrike të pafundme dhe të mbajnë sasi shumë të mëdha rryme elektrike pa nxehtë Xhaul).

"Temperatura kritike" (ndonjëherë e quajtur edhe temperaturë kalimtare) e një materiali superpërcjellës është temperatura në të cilën materiali e humbet rezistencën e tij ndaj rrymës së drejtpërdrejtë.

Shënime teknike:

Gjendja "superpërcjellëse" e një materiali karakterizohet individualisht nga një "temperaturë kritike", një fushë magnetike kritike, e cila është një funksion i temperaturës; ose dendësi rryme kritike, e cila është një funksion i fushës magnetike dhe temperaturës.

ML22 "Teknologji"

Informacionet specifike të detyrueshme për "zhvillim" "prodhim" ose "përdorim" të produktit të caktuar. Informacioni ka formën e "të dhënave teknike" ose të "asistencës teknike".

Shënime teknike

1. *"Të dhënat teknike" mund të jenë në formën e skicës teknike, diagramit, modelit, formulës, tabelës, konstruktit ose specifikimit inxhinierik, udhëzimeve ose instruksioneve me shkrim ose në forma të tjera komunikimi ose pajisje siç janë disqet dhe memoriet ROM.*

2. *"Asistenca teknike" mund të jetë në formën e udhëzimeve, aftësive, trajnimit, njohurive të punës dhe shërbime të konsulencës. "Asistenca teknike" mund të përfshijë transmetimin e të dhënave "teknike".*

ML 10 , "Avion pa pilot"

Çdo "avion" i cili është në gjendje të fluturojë dhe drejtojë fluturimin me navigacion, pa kontrollin e njeriut.

ML21, 22 "Përdorim"

Përdorimi, instalimi (duke përfshirë instalimin në vend), mirëmbajtja (kontrolli) riparimi, remonti dhe rinovimi"